

SISTEMI FINANCIAR SHQIPTAR NË TRANZICION: PROGRES APO BRISHTËSI?

Abstrakt

Në këtë kumtesë analizohen zhvillimet në sistemin bankar si pjesa më e rëndësishme e sistemit tonë financiar të para në kontekstin dhe lidhjen me zhvillimet makroekonomike duke vënë theksin në dy momente krize dhe turbullirash të këtij sistemi në vitet 1997 dhe 2002. Ndërsa kriza e parë financiare ishte një krizë e shkaktuar nga skemat piramidale dhe jo shumë e lidhur me sistemin bankar momenti i dytë përfaqëson një shqetësim të pastër të sistemit bankar i cili shënoi një prag krize bankare.

Në këtë kumtesë, ne analizojmë tiparet kryesore të sistemit bankar dhe faktorët e ndryshëm që qëndrojnë në themel të zhvillimeve të sektorit bankar duke arritur konkluzionin se megjithë progresin e dukshëm, sistemi bankar mbetet i brishtë dhe i ekspozuar ndaj krizave dhe shqetësimeve serioze që mund të shndërrohen në kriza bankare. Analiza e krizës financiare të shkaktuar nga skemat piramidale dhe pasojat që ajo solli veçanërisht në formimin e pritjeve të publikut shërben si bazë për shpjegimin edhe të tronditjeve të fundit në sistemin bankar.

Zhvillimi i sistemit bankar dhe rritja e besimit të publikut ndaj tij lidhet jo vetëm me zhvillimin dhe shëndoshjen e tij nëpërmjet privatizimit të bankave shtetërore, nxitjes së konkurrencës, përsosjes së sistemit të pagesave dhe forcimit të mbikëqyrjes, por edhe të zhvillimit të ekonomisë reale dhe stabilitetit politik të vendit.

1. HYRJE

Në procesin e transformimit të një vendi me ekonomi të centralizuar në një vend me ekonomi të mbështetur në tregun e lirë, krahas problemeve madhore si përballimi i inflacionit dhe sigurimi i ritmeve të qëndrueshme të rritjes ekonomike, që përbëjnë kushte bazë të një transformimi të suksesshëm, një vend qendror zë transformimi dhe reforma e sistemit financiar dhe veçanërisht në sektorin bankar. Duke qenë se tregu financiar dhe institucionet e tjera financiare jobanka zënë një peshë fare të vogël, prej 5për qind të të gjithë sistemit bankar në vitin 2001 (Ibrahimi, Salko, 2001) do të përqendrohemi në analizën e sektorit bankar.

Në këta 12 vjet tranzicioni është shënuar një progres i dukshëm jo vetëm në drejtim të qëndrueshmërisë makroekonomike por edhe në zbatimin të reformave të thella strukturore përfshirë dhe reformën e sektorit bankar. Pavarësisht nga kushtet e pafavorshme të nisjes të ekonomisë shqiptare dhe të sektorit bankar¹ (Hadëri, Ibrahimi, 1996), sistemi bankar shqiptar është zhvilluar hap pas hapi duke u zgjeruar me banka të reja private, nëpërmjet privatizimit dhe ristrukturimit të bankave shtetërore, nëpërmjet shtrirjes së rrjetit bankar, përsosjes së legjislacionit dhe sistemit të pagesave, përsosjes së teknologjisë dhe shërbimeve bankare, rritjes së nivelit të kreditimit, rritjes së nivelit të frytshmërisë dhe shtimit të shërbimeve të tjera bankare.

Megjithë progresin e ekonomisë shqiptare² dhe të sektorit bankar, ky i fundit është ende i ekspozuar ndaj krizave dhe karakterizohet nga luhajtja e besimit të publikut ndaj tij, nga niveli jo i përshtatshëm i sistemit të pagesave, nga konkurrenca e pamjaftueshme dhe dominimi i sistemit nga një bankë e vetme³, nga mungesa e një tregu bankar të zhvilluar, nga mungesa e një kuadri ligjor plotësisht eficient etj.. Dëshmia më e qartë e brishtësisë së sistemit bankar janë kriza financiare e vitit 1997, e shkaktuar nga rënia e skemave piramidale dhe kriza e depozitave bankare në fillim të vitit 2002.⁴

Kumtesa jonë do të përqendrohet pikërisht në analizën e këtyre momenteve kulmore negative duke synuar t'iu përgjigjet pyetjeve që nxjerr në pah zhvillimi i sistemit bankar në vitet e tranzicionit. Tranzicioni shqiptar dëshmon se

¹ Trashëgimia nga sistemi i centralizuar ku paraja shërbente thjesht si njësi llogarie dhe luante një rol të kufizuar si mjet këmbimi përbën një nga shkaqet e rëndësishme të prapambetjes relative të sektorit bankar në tranzicion

² Ekonomia shqiptare ka dëshmuar se konsolidimi makroekonomik është ende i brishtë, me çbalancime të jashtme dhe fiskale, me të ardhura për frymë nga më të ulëtat në Europë, me varfëri relativisht të lartë dhe me institucione relativisht të dobëta. Konsolidimi makroekonomik mund të priset aq shpejt sa vendoset (viti 1997), bilanci tregtar është i çbalancuar, deficitit buxhetor dhe borxhi në nivele të konsiderueshme, tregu financiar vazhdon të jetë në nivel të ulët zhvillimi etj. (Kule, Hadwri 2001).

³ Në prill të vitit 2002 Banka e Kursimeve zinte 59.2 pwr qind të sistemit bankar.

⁴ Në 20 vitet e fundit, mjaft vende të botës janë prekur nga kriza financiare të ndryshme ku evidentohen kriza në vendet nordike gjatë fillimit të viteve '90-të dhe më vonë, në fund të viteve '90-të, kriza aziatike (Kore dhe Tailandë). Në këtë periudhë, vend të veçantë zwnë krizat që goditën ekonominë në tranzicion si Bullgaria në vitet '96-97 që përjetoi një ndër krizat më të thella të vendeve në tranzicion, Lituania më herët, në vitet '94-95 dhe Mongolia në vitin 1996 që përjetoi krizë të ngjashme me ato të vendeve të tjera në zhvillim.

përkundrejt një zhvillimi relativisht të qëndrueshëm ekonomik, i matur në termat e rritjes ekonomike dhe inflacionit, sistemi bankar shfaq edhe dobësi dhe mbetet i ekspozuar ndaj goditjeve. Madje krizat financiare janë shfaqur në momente të tilla që shpeshherë janë quajtur edhe "paradoksi shqiptar". Kriza financiare që shoqëroi rënien e piramidave shpërtheu kur Shqipëria shfaqte një performancë impulsive makroekonomike (IMF, World Bank) dhe konsiderohej e suksesshme në zbatimin e reformave ndërsa tërheqja e depozitave filloi në momentin kur sistemi bankar ishte në nivele performance më të mira se kurrë ndonjëherë më parë.

Në këto kushte shtrohet pyetja se cilët janë këta faktorë që kushtëzojnë brishtësinë e sistemit bankar? Paqëndrueshmëria buron nga natyra e sistemit apo nga faktorë jashtë tij? Cilat janë ndikimet më afatgjata të krizës piramidale që u ndikua relativisht pak dhe ndikoi në të njëjtën masë në sektorin bankar në momentin e shpërthimit dhe zgjidhjes së saj? Pse "paradoksi shqiptar" u ripërsërit me pothuajse krizën e likuditetit, e cila shpërtheu në një kohë kur sistemi bankar kishte performancën e tij më të mirë gjatë viteve të tranzicionit? Si u menaxhuan këto kriza dhe cili ishte roli i Bankës së Shqipërisë në krizën e likuditeteve?

2. ZHVILIMET NË SEKTORIN BANKAR '91 – '96.

2.1. Trashëgimia socialiste e sistemit bankar.

Tranzicioni e gjeti Shqipërinë si vendin më të varfër të Europës (tabelë 1⁵), si një vend komunist me tipare të ngjashme me vendet tjera socialiste dhe veçanërisht me ato të Europës Juglindore por edhe me veçori të theksuara që e dallojnë atë nga vendet e tjera ishkomuniste.⁶ Shqipëria ishte i vetmi vend europian i bllokut komunist që nuk ndërmori asnjë reformë të rëndësishme ekonomike dhe politike si decentralizimi i vendimmarrjes, rritja e rolit të tregut dhe demokratizimi i vendit, vendi që gjatë 45 vjetëve zbatoi në mënyrë rigorozë ideologjinë marksiste dhe praktikën staliniste. Shqipëria hyri në tranzicion si vendi më pak i përgatitur nga pikëpamja ekonomike, politike, sociale dhe kulturore për të realizuar reforma rrënjësore drejt ekonomisë së tregut. (Kule, Hadëri 2001).

Sistemi bankar gjatë socializmit ishte një sistem i centralizuar plotësisht dhe deri në vitin 1976 përbëhej nga një bankë e vetme, Banka e Shtetit Shqiptar, që shërbente në të njëjtën kohë si autoritet monetar dhe si kredituese e ekonomisë. Ndërkohë roli i saj si ndërmjetës financiar ishte mjaft i kufizuar, pasi si politika monetare ashtu dhe shpërndarja e kredisë drejtohej sipas një plani të

⁵ Bashkëngjitur materialit, do të gjeni tabelat e referuara.

⁶Modeli shqiptar u karakterizua nga eliminimi i të gjitha formave të pronës private nëpërmjet shtetëzimit të plotë të industrisë dhe kolektivizimit të bujqësisë; nga mbështetja e plotë në planifikim dhe drejtimin e centralizuar duke mos lenë pothuajse asnjë rol për përndarjen e burimeve nga tregu; nga zbatimi ekstrem i parimit të mbështetjes në forcat e veta dhe të pavarësisë ekonomike; nga një mungesë pothuajse e plotë e traditës demokratike dhe nga zbatimi ekstrem i parimit të luftës së klasave i cili i ruan pasojat edhe në vitet e tranzicionit Për një trajtim më të hollësishm shih IMF (1992), Pashko (1994), Muço 1997, Hadëri et al.(1999), Kule, Hadëri, 2001 .

centralizuar. Banka shërbente thjesht si institucion rregjistruar i transaksioneve midis ndërmarrjeve prodhuese. Përveç Bankës së Shtetit Shqiptar funksiononte edhe Drejtoria e Përgjithshme Arkave të Kursimit dhe të Sigurimeve që kryente grumbullimin e kursimeve të popullsisë si dhe merrej me sigurimin e pasurisë, kryesisht të asaj kooperativiste⁷. Në vitin 1977 u krijua Banka Bujqësore si një bankë e veçantë nëpërmjet shkëputjes së një seksioni të Bankës së Shtetit Shqiptar që mbulonte ofertën për fonde të sektorit bujqësor. Në vitin 1990, Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë të Bankës së Shtetit Shqiptar shërbeu si bazë për themelimin e Bankës Tregtare Shqiptare e cila kryente funksionin e financimit dhe të nxitjes së eksporteve dhe të pagesave me jashtë. (Cani, 1995.)

Në mënyrë të përmbledhur sistemi bankar socialist në pragun e tranzicionit karakterizohej nga mangësi serioze për një sistem bankar të ekonomisë së tregut të lirë si (i) roli i tij si ndërmjetës financiar ishte mjaft i kufizuar, sepse bankat shërbenin thjesht si institucion rregjistruar i transaksioneve midis ndërmarrjeve prodhuese; (ii) në këto kushte mungonte vlerësimi i kredisë dhe për rrjedhojë edhe menaxhimi i riskut; (iii) kursi i këmbimit llogaritej por jo risku i tij (iv) sistemi i kontabilitetit kishte si funksion kryesor regjistrimin dhe monitorimin e plotësimit të objektivave të planit të përgjithshëm dhe në këtë kuptim ai ndryshonte rrënjësisht nga praktikat ndërkombëtare të kontabilitetit, ndryshim që shfaqej në mënyrë të veçantë në sektorin bankar; (v) mungesa e përvojës bankare për aktivitetet e një ekonomie tregu përbën një faktor tjetër negativ dhe drejtuesit e bankave nuk kishin përvojë ndërkombëtare.

Perioda e pragtranzicionit u shoqërua me rënie të ndjeshme PBB me 13% në vitin '90 dhe 27.7% në vitin '91, rënie që kishte filluar të ndjehej që në mesin e viteve '80. Llogaria korente u përkeqësua ndjeshëm si rezultat i rënies drastike të eksporteve dhe rritjes së ndjeshme të importeve veçanërisht për mallrat e konsumit. Deficiti tregtar arriti nivelin 150 milionë usd në vitin '90 dhe 308 milionë usd në vitin '91.

Deficiti buxhetor, që në vitet e fundit të regjimit komunist u financua me depozitat në Bankën e Shtetit, me fillimin e tranzicionit shfaqti një rritje të menjëhershme për shkak të kolapsit të sistemit të mbledhjes së të ardhurave dhe shpenzimeve të detyruara shtetërore për pagat dhe për subvencionet e ndërmarrjeve shtetërore me humbje. Deficiti buxhetor në vitet '90-92 arriti respektivisht 15, 31, dhe 44 % e PBB. Ekspansioni monetar doli jashtë kontrollit sepse banka emtoi para pa asnjë kufizim, për shkak të presionit qeveritar për të kredituar ndërmarrjet me humbje. Kjo ndikoi ndjeshëm në rritjen e huave të këqija në këto banka, pas fillimit të reformave në vitin '92. Normat e interesit për

⁷ Drejtoria e Arkave të Kursimit dhe Sigurimeve nuk përfaqësoje një bankë sepse ajo nuk jepte kredi dhe mjetet monetare të depozituara nga popullata përdorehin nga buxheti.

kreditë ishin mjaft të ulta, 3%, dhe 5-8% në vitet '90, '91 dhe deri në mes të vitit '92, ndërsa gjobat për kreditë e pakthyrë nuk u aplikuan më. Për rrjedhojë, paraja gjithsej u rrit me një normë vjetore mjaft të lartë prej 21%, 152% dhe 180% respektivisht në vitet '90, '91 dhe mesi vitit '92. (IMF Economic Review 5, 1995.)

2.3. Reformat e tranzicionit dhe ndryshimet strukturore të sistemit bankar '91-97.

Si pjesë e reformës ekonomike të filluar në vitin 1992, reforma e sistemit bankar filloi si reformë institucionale me ndryshimin e bazës ligjore. Kuvendi, në prill të vitit 1992, miratoi ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", si dhe ligjin "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë". Këto ligje shënuan kalimin e sistemit bankar nga një nivelor në një sistem bankar prej dy nivelesh. Mbi bazën e këtyre ligjeve iu hap rruga procesit të licencimit të bankave të reja private dhe rregullimit të sistemit bankar nga banka qendrore.

Banka e Shqipërisë u krijua si bankë e nivelit të parë, banka qendrore e vendit, ndërkohë që tri banka të tjera shtetërore: Banka e Kursimeve, Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka Tregtare Agrare, përbënin nivelin e dytë të sistemit bankar. Banka e Kursimeve ishte pasardhëse e Institutit të Kursimit me një status të ri si një bankë universale. Banka Kombëtare Tregtare ishte një shkrirje e aktivitetit tregtar të brendshëm të Bankës së Shtetit Shqiptar me Bankën Tregtare Shqiptare.

Gjithashtu, në vitin 1992 u licencuan dy banka me kapital të përbashkët (të huaj dhe të Qeverisë Shqiptare): Banka Italo-Shqiptare dhe Banka Arabo-Shqiptare Islamike. Në vitin 1993 u krijua Banka Dardania nga Qeveria e Kosovës dhe në vitin 1996 u licencuan dy banka me kapital grek: Banka e Tiranës dhe Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë.

Karakteristikë e zhvillimit të sektorit bankar në këto vite është dominimi i bankave me kapital shtetëror, megjithëse vihet re një rritje e lehtë e peshës së grupit G2 dhe G3 nga njëri vit në tjetrin. Në tabelën 3 jepet pesha e secilit grup në sistemin bankar sipas pronësisë së kapitalit⁸.

Pavarësisht nga njohuritë e pakta mbi bankingun, të trashëguara nga ekonomia e centralizuar, vihet re prirja e rritjes së aktivitetit bankar megjithëse me ritme të ngadalta. (tabelë 4) Në vitin 1994, në vend operonin 6 banka me një total aktivesh prej 146.2 miliardë lekësh, që përbënin 79% të PBB-së të atij viti ku peshën kryesore e zinte Banka Kombëtare Tregtare (77% të aktiveve të sistemit).

⁸ Grupimi i bankave në bazë të pronësisë së kapitalit është kriteri që do të përdoret deri në fund të materialit. Kështu, në G1 bëjnë pjesë bankat me kapital shtetëror, G2 bankat me kapital të përbashkët dhe G3 bankat private.

Në vitin 1995 kemi rënie të totalit të aktiveve të sistemit në 80.8 miliardë lekë (ose 35% të PBB-se). Në këtë rënie ndikoi Banka Kombëtare Tregtare, mjetet kryesore (aktive të tjera të bankës) të së cilës u reduktuan në 6 miliardë lekë në vitin 1995, nga 90.7 miliardë lekë që rezultonin në vitin 1994⁹, ndërkohë që bankat e tjera shfaqin rritje të aktivitetit të tyre krahasuar me një vit më parë.

Në vitin 1996 totali i aktiveve të sistemit bankar arrin në 128.8 miliardë lekë ose 46% të PBB-së. Rritja e aktiveve të sistemit bankar prej 48 miliardë lekësh i përket kryesisht Bankës Kombëtare Tregtare (me 41 miliardë lekë), pasi bankat e tjera shfaqin rritje të lehta. Kjo rritje e aktiveve të BKT-së është rezultat i rritjes së llogarive rrjedhëse dhe depozitave pa afat nga firmat piramidale¹⁰.

Gjatë kësaj periudhe u bënë një sërë përpjekjesh për ristrukturimin dhe përgatitjen e bazës ligjore për privatizimin e bankave, përpjekje të cilat përgjithësisht nuk rezultuan efektive.¹¹

2.3. Probleme dhe vështirësi të sistemit bankar në vitet e para të tranzicionit.

Krahas zhvillimeve pozitive, por të brishta, sektori bankar u shoqërua edhe me mjaft mangësi dhe zhvillime negative, të cilat megjithëse pranohet që nuk ishin shkak kryesor i krizës së vitit '97 (Jarvis 2001, Cani and Vika, 2002) ndihmuan në shfaqjen dhe thellësinë e saj. Së pari, niveli i ndërmjetësimit financiar ishte i kufizuar. Bankat shtetërore që dominonin me rreth 90 % tregun e depozitave, kryenin funksione të kufizuara të ndërmjetësimit financiar, ndërsa bankat e reja private ishin të kufizuara në numër, tepër të ngadalta dhe të painteresuara për tërheqjen e depozitave në lekë duke u përqendruar kryesisht në kreditimin e tregtisë. Niveli i depozitave nuk varej shumë nga normat reale të interesit sepse banka qendrore vendoste norma të tilla interesi që siguronin nivele pozitive të normave reale. Niveli mjaft i ulët i kreditimit të ekonomisë përbën një mangësi tjetër të sistemit bankar që shpreh dhe shkallën e ulët të ndërmjetësimit.

Një mangësi tjetër e theksuar e sektorit bankar në këtë kohë ishte niveli i ulët i sistemit të pagesave. Kështu për shembull, në fundin e vitit 1996 realizimi i pagesave për transaksione nëpërmjet llogarive në degë të ndryshme të të njëjtës bankë kërkonte mesatarisht 5 – 6 ditë, ndërsa për transaksione ndërmjet bankave të ndryshme kërkonte mbi 15 ditë. (Cani 1995, Jarvis 2001) Për këto arsye paraja jashtë bankave në duar të publikut ishte në nivele shumë të larta. (tabelë 1.)

⁹ Ky reduktim është për shkak të pastrimit të disa llogarive të vjetra nga bilanci i kësaj banke.

¹⁰ Firmat rentiere, si u quajtën në atë kohë, hapën llogari rrjedhëse dhe depozita pa afat pranë BKT-së në vitin 1996, për rreth 38 miliardë lekë.

¹¹ Për një trajtim më të hollësishëm shih Cani "Restructuring of the Banks in Albania" në Restructuring Eastern Europe, The microeconomics of the Transition Process edited by Soumitra Sharma, Edward Elgar 1995.

Mungesa e një sistemi rregullues dhe mbikëqyrës të përshtatshëm si dhe mungesa e kulturës dhe traditës për kthimin e huasë, ndikuan në rritjen e nivelit të huave të këqija. Vitet e para të tranzicionit u shoqëruan me një rënie të aktivitetit ekonomik për shkak të dobësive të ndërmarrjeve shtetërore, sidomos në degët e industrisë me teknologji të vjetër dhe me kërkesë në rënie, degë që përfaqësonin konsumatorë të rëndësishëm të bankave shtetërore. Vazhdimi i kreditimit të këtyre ndërmarrjeve me prodhim të ulët, shumë herë edhe me ndërhyrjen e qeverisë, ndikoi ndjeshëm në rritjen e huave të këqija në këto banka. Ndikimi politik në vendimet e huadhënies u rrit me përkeqësimin e situatës fiskale, për shkak të shkatërrimit të burimeve tradicionale të të ardhurave të buxhetit dhe rritjes së borxhit në vitet e para të tranzicionit. Kredia e pakthyer në afat u rrit nga 14% e stokut të kredisë në vitin '93 në rreth 60% në vitin 1997. (Cani 1995, Ibrahimimi dhe Salko, 2001)

Roli i bankave si ndërmjetës financiar midis huadhënësve dhe huamarrësve në këtë periudhë ishte i kufizuar edhe për shkak të mungesës së një mekanizmi të duhur të falimentimit dhe të likuidimit, prandaj bankat shtetërore ishin pak të motivuara për të qenë të kujdesshme në normat e interesit që u ofronin depozituesve si dhe në ndjekjen e huave jashtë standardit. (IMF 2002)

Në periudhën e ekonomisë së centralizuar, sistemi i kontabilitetit kishte si funksion kryesor regjistrimin dhe monitorimin e plotësimin të objektivave të planit të përgjithshëm dhe në këtë kuptim ai ndryshonte rrënjësisht nga praktikat ndërkombëtare të kontabilitetit, ndryshim që shfaqej në mënyrë të veçantë në sektorin bankar. Në këtë sektor mungonte kontabiliteti i të drejtave të konstatuara, trajtimi i përshtatshëm kontabël i huave të pakthyer në kohë, gjë që nuk pasqyrore menjëherë dhe qartë përkeqësimin e pozicionit të bankës.

Përvoja mbikëqyrëse e bankës qendrore ishte shumë e kufizuar si për shkak të mungesës së kësaj përvoje në kushtet e një ekonomie tregu ashtu edhe për shkak të autoritetit të kufizuar mbikëqyrës dhe të ngadalësisë në vendosjen e këtij autoriteti. Nga ana tjetër, drejtuesit e bankave shtetërore dhe private nuk ishin të interesuar që roli mbikëqyrës të rritej, ndërkohë që edhe punonjësit e mbikëqyrjes së bankës qendrore ishin të pamotivuar, para së gjithash materialisht, për t'u ndeshur me drejtuesit e këtyre bankave. Madje në rastet kur ky sistem mbikqyrës ishte në nivelin e duhur dhe përcaktonte shkeljet e rregullave, këto nuk shoqëroheshin me vendosjen e penalteteve të parashikuara. Në themel të këtyre dukurive qëndronte dhe fuqia politike dhe ekonomike e drejtuesve të bankës, që shumë herë ishin njerëz me pushtet që përfaqësonin interesat e partisë në fuqi. Në vitet e para të tranzicionit, kur vetë ligji dhe zbatimi i tij ishte i dobët, frika e këtyre individëve nga ligji ishte minimale.

Nga ana tjetër, mungesa e kërkesave ndaj kapitalit minimal dhe mungesa e rregulloreve të përshtatshme të klasifikimit të huave nga humbjet si dhe të vetë rregullave të provigjonimit, shtrembëronte pozicionin real të bankave në sistemin e raportimit.

Kuadri ligjor i papërshtatshëm në vitet e para të tranzicionit përbën një dobësi tjetër të zhvillimit të sistemit bankar. Kjo shprehet si në fuqinë e bankës qendrore për të vendosur rregulla mbikqyrëse në licencim, në mungesën e ligjit të falimentimit, në zbatimin e dobët të tij nga gjykatat, në mungesën e ligjit të kolateralit ashtu edhe në moszbatimin e ligjeve kur ato ekzistojnë.

Mungesa e përvojës bankare për aktivitetet e një ekonomie tregu përbën një faktor tjetër negativ. Shumë nga drejtuesit e bankave nuk kishin përvojë ndërkombëtare dhe vinin nga sektorë të tjerë shtetërorë, madje edhe nga sektorë pa përvojë financiare. Vështirësitë në drejtimin e bankës dhe ndërrimin e funksionarëve të lartë politikë shumë herë u shoqërua me zëvendësimin e drejtuesve të bankës, që në disa raste ata qarkullonin nga një bankë në tjetrën. Kjo krijonte mundësinë që drejtuesit e rinj ta shkarkonin përgjegjësinë tek drejtuesit e mëparshëm, duke mos mbajtur përgjegjësi për problemet që kishin shkaktuar vetë në bankat e tjera.

Nga ana tjetër, edhe bankat e huaja që filluan gradualisht të futeshin në tregun bankar, për shumë kohë u përqendruan në aktivitete pa rreziqe dhe duke punësuar dhe personelin më të kualifikuar. Në këtë mënyrë ato ngushtuan në njëfarë mase mundësitë fitimprurëse për bankat vendase duke ruajtur një ecuri të mirë edhe në periudha të paqëndrueshme si ajo e viteve 1992-1997. (IMF 2002)

3. SKEMAT PIRAMIDALE DHE KRIZA FINANCIARE E VITIT 1997.

3.1. Kuadri makroekonomik dhe kriza financiare.

Zhvillimet në sektorin real gjatë periudhës '92 –'96 karakterizohen nga një rritje e ndjeshme ekonomike prej 9% në vit, një rënie e inflacionit në nivel mesatar prej 17,5% dhe nga një përmirësim i ndjeshëm i llogarisë korente dhe i deficitit buxhetor të cilat ngelen gjithësesi në nivele mjaft të larta. Progresi në stabilizimin makroekonomik e ka bazën në hartimin dhe zbatimin e politikave të shtrënguara monetare dhe fiskale dhe në privatizimin me ritme të shpejta në bujqësi, në tregti me pakicë dhe shumicë, në ndërmarrjet e mesme dhe të vogla, të cilat gjallëruan rritjen ekonomike.¹² Një hap i ndjeshëm u shënuar në pavarësinë e Bankës Qendrore me ligjin e ri të vitit 1996, që përforcon ruajtjen e stabilitetit të

¹² Gjatë kësaj periudhe privatizimi i tokës bujqësore arriti në 93% në fund të vitit 1993, reforma e sistemit tatimor progresoi me futjen në vitin 1996 të tatimit të vlerës së shtuar-TVSH, filloi funksionimin tregu i bonove të thesarit dhe i privatizimit masiv me bono, ndërkohë që shumica e ndërmarrjeve të vogla u privatizua.

gmimeve si objektiv themelor të Bankës së Shqipërisë. Gjithësesi, politika monetare e ndjekur mbështetëj në kontrollin e rritjes së parasë nëpërmjet instrumenteve direkte si tavanet e kredisë dhe kontrolli I normave të interesit për depozitat.

Përkundrajt faktit të rritjes ekonomike me 9.1% në vitin 1996, ky vit me zhvillimet e veta negative politike dhe ekonomike si zgjedhjet e kontestuara, që u paraprinë nga shpenzimet e mëdha buxhetore për qëllime elektorale, rritjen e pabazuar të pagave, shtyrjen e futjes së TVSH- së në paketën fiskale, zgjerimin galopant të skemave piramidale, jo vetëm që i kontribuoi krizës së thellë të vitit 1997 por, në shumë tregues makroekonomikë, kriza u shfaq qartë që në fund të vitit 1996 me trefishimin e inflacionit në 17.4% në krahasim me fundvitin '95 dhe rritjen e deficitit buxhetor në 12.9%. (Kule, Hadëri, 2001) Mbas fitores së zgjedhjeve nga partia në pushtet dhe kontestimit të gjerë ndërkombëtar të tyre, partia në fuqi e kishte shumë më të vështirë për të marrë vendimet e duhura të rëndësishme sepse ato binin ndesh me autoritetin e saj të brishtë.

Niveli ulët i zhvillimit të sistemit bankar dhe sidomos zhvillimet makroekonomike negative të vitit 1996 kontribuan në shpërthimin e krizës së vitit 1997, por edhe u ndikuan nga veprimi i faktorëve të tjerë të rëndësishëm që çuan në zhvillimin dhe rënien e skemave piramidale si tregu informal i kredisë, kuadri i pamjaftueshëm ligjor dhe faktorët politikë.

3.2. Tregu joformal i kredisë dhe skemat piramidale. Përse?

Prapambetja e zhvillimit të sektorit bankar dhe mangësitë të tij ushqyen dhe u kushtëzuan nga lindja dhe zhvillimi i tregut informal të kredisë që në fillimet e tranzicionit. Ky treg që lindi si rezultat i tolerancës së autoriteteve shtetërore dhe i mungesës së kuadrit ligjor rregullator përbëhej si nga kambistët e palicencuar të tregut valutator ashtu edhe nga kompanitë që merrnin depozita dhe jepnin me to hua, të cilat ishin joligjore meqenëse nuk ishin të licencuara për marrje depozitash. Sistemi bankar me ineficiencën e tij si ndërmjetës financiar krijoi hapësirat për piramidat që të thithnin kursimet në rritje, veçanërisht kursimet e emigrantëve¹³. Normat e interesit që ofronin këto kompani për depozitat ishin tepër të larta dhe lëviznin nga 6 – 8 % në muaj, por gjithësesi nën nivelin e normave të kredisë për të cilat të dhënat mungojnë. Rritja e madhe këtyre normave të interesit në vitin 1996 edhe për shkak të heqjes së sanksioneve ndaj ishJugosllavisë, nxorën jashtë loje normat e interesit të ofruara nga sistemi bankar dhe, për rrjedhojë, efektiviteti i politikës monetare u bë inekzistent.

¹³ Këto kursime në këtë periudhë vlerësohen në rreth 300 milionë dollarë në vit. Sistemi i kredisë joformale përbëhej kryesisht nga hua private që emigrantët u jepnin miqve dhe familjes, hua që përgjithësisht arrinin në 30 mijë usd dhe nuk shoqëroheshin me kolateral, por shoqëroheshin me norma shumë të larta interesi.

Normat e larta të interesit çuan në prurje të mëdha depozitash në sportelet e këtyre firmave ndërkohë që investimi i tyre në prodhim dhe në letra me vlerë ishte minimal krahasuar me shumën e mbledhur. Nga ana tjetër, u shfaq dukuria e riinvestimit të principalit bashkë me interesat nga kilientët. Pamundësia e administrimit të depozitave nga ana e firmave bëri që këto të fundit t'i depozitonin ato në llogari rrjedhëse në bankat tregtare, duke ju krijuar atyre rezerva të tepërta në sasira të mëdha, të cilat shkonin drejtpërsëdrejti në blerje bonosh thesari, në përgjigje të kërkesave të mëdha të buxhetit për likuiditet.

Fillimisht ky treg informal krediti vlerësohej si pozitiv nga autoritetet shqiptare, sepse në kushtet e mangësive të sistemit formal bankar, gjykohej se, kompanitë që vepronin në këtë treg realizonin një ndërmjetësim financiar duke nxitur investime fitimprurëse dhe rritjen ekonomike.

Krahas firmave të kreditit informal, që në fillimet e tranzicionit filluan të vepronin edhe firma që merrnin hua me norma të larta interesi, që "investonin" brenda tyre pa iu dhënë kredi të tjerëve. Këto u kthyen me kalimin e kohës në firma piramidale. Këto firma që ofronin interesa 4 –5 % në muaj deri në fund të vitit 1995 i përdorën paratë në një mënyrë të paqartë. Në disa raste ato i investonin në aktivitete prodhuese ndërsa në disa raste besohet se financonin aktivitete kriminale si kontrabanda, emigracioni ilegal, droga, prostitucioni dhe trafiku i armëve.¹⁴

Megjithë dallimet midis tyre, dallime që vështirë se mund të evidentoheshin, në të dyja rastet si burime për këto firma shërbyen kursimet e brendshme dhe dërgesat e emigrantëve që kapnin shifra të konsiderueshme. Kur shtrirja e tregut joformal arriti përmasa të mëdha, organizmat ndërkombëtarë filluan të shprehnin shqetësim për natyrën e tyre¹⁵.

Mungesa e kuadrit të përshtatshëm ligjor përbën një nga shkaqet kryesore të zhvillimit të skemave piramidale dhe të krizës financiare të vitit 1997. Shoqëritë që vepronin në tregun joformal mbështeteshin në kodin civil që u lejonte atyre huamarrjen në bazë shoqërie, por pa qenë të detyruara të mbikëqyreshin nga një autoritet i cili ishte i domosdoshëm për institucionet që pranojnë depozita dhe japin hua.

Megjithëse në vitin 1996 me ligjin e ri të sistemit bankar u përcaktua qartë se të gjitha subjektet që pranonin depozita të ndryshme duhet të licencoheshin dhe të mbikëqyreshin nga Banka e Shqipërisë, përsëri këto shoqëri nuk iu nënshtuan

¹⁴ Nisur nga natyra tyre ishte vështirë të përcaktohej saktësisht aftësia paguese e tyre, pra fakti nëse ato fitonin më shumë nga aktivitetet ilegale se sa u paguanin depozituesve. Disa prej tyre mund të kenë qenë të tilla që në momentin e krijimit, ndërsa disa të tjera u bënë firma piramidale gjatë vitit 1996.

¹⁵ Për shembull, në fund të vitit 1995 misioni i FMN për problemet e sektorit financiar studioi mundësitë e përmirësimit të sistemit formal financiar nëpërmjet integritit të elementeve pozitive të tregut informal.

licencimit dhe mbikëqyrjes. Kërkesës së Bankës së Shqipërisë për të licencuar dhe mbikëqyrur këto firma iu kundërvunë edhe disa zyrtarë të lartë, që mbronin pikëpamjen se ligji i ri i sistemit bankar nuk është i vlefshëm për shoqëritë huamarrëse, ndërkohë që organet shtetërore qëndruan indiferente ose akoma më keq edhe mbështetën zhvillimin e këtyre shoqërive.

Faktori politik që konsiston në mbështetjen që qeveria iu dha firmave piramidale përbën një shkak tjetër të zhvillimit të tyre. Kjo mbështetje buronte nga lidhjet që kishin zyrtarë të rëndësishëm me këto firma, nga financimi që ato i bënin partisë në pushtet, siç ishin zgjedhjet e vitit 1996 dhe shprehej në forma nga më të ndryshmet duke u angazhuar në aktivitete promovuese të këtyre firmave, duke bërë deklarata në favor të tyre dhe duke ua konsideruar aktivitetin si të pastër dhe të dobishëm. Mbështetja shfaqet edhe në faktin që atyre nuk u kërkohej që të paguanin detyrimet fiskale ose kurrë nuk u hetuan për shmangie fiskale.

Faktorët politik që vepruan në vitin 1996 nxitën edhe bumën e këtyre shoqërive duke përgatitur në të njëjtën kohë rënien dhe krizën. Ishin këto zhvillime, të cilat u lidhën dhe me zgjedhjet e kontestuara, me vendimet politike që përkeqësuan treguesit makroekonomikë siç ishin rritjet në pagat dhe të shpenzimeve buxhetore në funksion të fitimit të mandatit qeverisës, të cilat u kthyen në bumerang mbas kontestimit të zgjedhjeve të majit të vitit 1996.

Nevoja për të vërtetuar drejtësinë e këtyre zgjedhjeve nuk e lejoi qeverinë që të vepronte ndaj skemave piramidale duke menduar për zgjedhjet lokale të tetorit si test që vërtetonte drejtësinë e zgjedhjeve të majit. Megjithë presionin në rritje, veçanërisht të organizmave ndërkombëtarë, qeveria qëndroi pasive madje shumë herë doli hapur në mbrojtje të këtyre skemave duke i quajtur ato "skemat piramidale më të pastra në Europë" duke dëshmuar se problemi ishte më i gjerë se mbështetja politike, pasi *ishte paaftësi qeverisëse për të menaxhuar situatën në kohë*.¹⁶ Rënia e skemave piramidale në fillim të vitit 1997 çoi në një krizë të gjithanshme, e cila filloi si krizë financiare. Vendi kaloi në një anarki totale. Qeveria humbi kontrollin e vëndit, revoltat u kthyen në një kryengritje të armatosur, sistemi financiar u godit rëndë. (Jarvis, 2001)

3.3. Pritjet e publikut dhe roli i tyre gjatë krizës.

Analiza e shkaqeve të krizës financiare të vitit 1997 e cila u shfaq si krizë e firmave piramidale ka në themel analizën e pritjeve dhe të informacionit për tregun financiar si dhe të karakteristikave të ambjentit ekonomik. Me të drejtë

¹⁶ Qeverisja jo e mire, e cila shprehet në nivelin e lartë të korrupsionit dhe në dobësitë institucionale dhe të tregjeve si dhe prapambetje e reformave strukturore, veçanërisht në sektorin bankar, përbëjnë faktorë të tjerë mjaft të rëndësishëm që ndihmuan krizën. Sipas EBRD (tabelë 5) indeksi i reformës në sektorin bankar në vitin 1996 ishte 2.0, ndërsa indeksi i politikave të konkurrencës dhe i reformës së institucioneve financiare jobankare ishte 1.7.

lind pyetja: cilët janë ata faktorë që nxisin pritje jorealiste lidhur me norma shumë të larta kthimi që mund të sjellë investimi në aktive financiare që ofrohen nga skemat piramidale?

Për të kuptuar se pse një masë e madhe njerëzish investoi në këto firma që ofrojnë interesa kaq të larta duhet analizuar sesi ata vlerësojnë fitimin dhe rrezikun. Përvoja që buron nga natyra dhe historia e sistemit ekonomik shërben si bazë për të formuar metodën e këtij vlerësimi. Sipas kësaj logjike shumica e eksperiencave apo e informacionit të mëparshëm sugjeron se norma kaq të larta kthimi mund të vijnë vetëm në dëm të të tjerëve dhe se herët a vonë këto firma, që ofrojnë norma të tilla, falimentojnë duke sjellë humbjen e plotë të investimit. Formimi i kësaj mënyre sjelljeje sigurisht kërkon kohë dhe eksperiencë dhe është normale për agjentët ekonomikë me histori në ekonominë e tregut, por jo për vendet socialiste ku veprojnë faktorë të tjerë.

Së pari, mungesa e traditës dhe e përvojës nga regjimi komunist reduktonte perceptimin e rrezikut nga popullata për shoqëritë që ofronin norma shumë të larta interesi për depozitat. Mungesa e njohurive për rrezikun tek depozituesit ndikoi në joshjen e tyre nëpërmjet normave të larta të interesit, pavarësisht nga rreziku i subjektit. Ky ishte një nga faktorët që lehtësoi krijimin e veprimtarive joformale jashtë sistemit bankar të cilat, në dallim nga shumë vende të tjera, në Shqipëri çuan në një krizë të gjithanshme politike dhe ekonomike me pasoja tepër të rënda.

Së dyti, mungesa e çdo përvoje të falimentimit në periudhën e parë të tranzicionit kishte formuar pritjet e një mbrojtjeje të nënkuptuar të qeverisë për depozituesit. Trashëgimia socialiste lidhur me ofrimin nga ana e shtetit jo vetëm të të ardhurave, por edhe të të gjitha garancive të tjera si puna, pensioni, arsimimi, shëndetësia ruajnë besimin tek individët se shteti është përgjegjës dhe i përgjegjshëm edhe për vendime që merren në mënyrë individuale në një ekonomi tregu. Ky besim i individëve tek shteti dhe përkrahja që shteti i dha këtyre shoqërive formoi pritjen se këto fitime të larta janë reale. Nga ana tjetër, edhe po qe se shqiptarët do të kishin dyshime për natyrën e skemave piramidale pritja e mbështetur mbi këtë trashëgimi ishte se shteti do t'i kompesonte ata po qe se skemat do të falimentonin. (Elbirt 1997)

Së treti, në këto vende veçanërisht në vitet e para të tranzicionit, njerëzit besojnë së tregu dhe kapitalizmi ofrojnë mundësi të tilla. Ky besim i gabuar shërben si bazë e krijimit të skemave piramidale, që në literaturën ekonomike konsiderohen si të mbështetura "në përshtypjen e gabuar apo në shmangien e një besimi të nënkuptuar apo të përcaktuar" si dhe në pikëpamjen e gabuar për vendet kapitaliste si vende ku "rrugët janë të shtuara me flori dhe të gjithë janë të pasur". Ekzistojnë shumë tregues të këtyre faktorëve iluzivë që shprehen në

historitë, të cilat shpjegojnë fitimet e larta të skemave gjatë kohës që ato lulëzojnë.¹⁷

3.4. Pasojat e krizës dhe zgjidhja e saj. Mësimet.

Efektet ekonomike të firmave piramidale janë të gjera, megjithëse me informacionin statistikor disponibël është vështirë që të maten me saktësi. Kriza e thellë ekonomike dhe politike e cila shpërtheu si rezultat i përmbysjes së skemave piramidale por që, në fakt, kishte filluar të shfaqej që në vitin 1996 dhe kishte një bazë më të gjerë, çoi në rënie të prodhimit në masën 7%, në rritje të inflacionit në masën 42 për qind dhe në keqësim të llogarisë korente dhe të deficitit fiskal. Në mesin e vitit 1997 leku u nënçmua pothuajse 100 për qind, ndërkohë që politika monetare u vu drejtpërdrejt në shërbim të sigurimit të likuiditeteve për buxhetin e shtetit.¹⁸

Pa u ndalur në detaje për implikimet e tjera makroekonomike, ajo që duhet theksuar është se kjo krizë ndikoi ndjeshëm në *humbjen e besimit publik në sistemin bankar, gjë që çoi në një hemorragji të pandalshme të parasë, ndërkohë që rënia e depozitave pa afat dhe në valutë ishte e pashmangshme*. Skemat piramidale patën ndikime të ndryshme mbi treguesit monetarë dhe sektorin bankar para dhe pas krizës. Para kolapsit të skemave, veçanërisht në vitin '96, siç paraqitet në tabelën ..., vihet re një rritje e parasë gjithsej si rezultat i rritjes së depozitave, të cilat gjatë 7 muajve të këtij viti u rritën me 37.3 miliardë lekë. E gjithë kjo rritje në depozita erdhi nga shoqëritë piramidale dhe për rrjedhojë raporti para – depozita pësoi një rënie të fortë nga 68% në qershor në 43% në nëntor të vitit 1996. Ndërkohë depozitat e tjera ndryshonin shumë pak. Nga ana tjetër, rritja e madhe e depozitave nuk u shoqërua me ekspansion monetar sepse aktiviteti huadhënës i bankave kufizohej edhe nga Banka Qendrore. Në këtë mënyrë, bankat rezultuan me rezerva të tepërta të cilat u përdorën për blerje të bonove të thesarit por jo në rritje të kredisë së sektorit privat.

Mbas krizës, efektet në treguesit monetar ishin të kundërta por që për fat patën efekte të kufizuara në ekonominë reale dhe në sektorin bankar. Fillimisht, në vitin 1997, siç del nga tabela... kemi një rënie masive të depozitave në sektorin privat. Sekuestrimi dhe shpërndarja graduale e mjeteve financiare të firmave piramidale si edhe tërheqja e tyre nga operatorët çoi në një rritje pothuajse dyfish të raportit para-depozitë, e cila tregon se njerëzit preferojnë t'i mbajnë parat e tyre në *cash*.

¹⁷ Për shembull, normat jashtwzakonisht të larta të interesit në kompanitë piramidale në Shqipëri shpjegoheshin me histori të tilla si fitime të larta që vinin nga një hotel në Kaliforni, nga shfrytëzimi i minierave që nuk ekzistonin apo nga parashikime që mbështeteshin në falle.

¹⁸ Për një trajtim të hollësishëm shih Chris Jarvis "The Rise and Fall of the Pyramid Schemes in Albania", IMF Staff Papers, Volume 47, Number 1, 2000.

Qeveria e re, pas mesit të vitit 1997, zbatoi një program postkrizë të mbështetur edhe nga donatorët ndërkombëtarë si edhe thelloi më tej reformat strukturore, veçanërisht në fushën e privatizimit të ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha si edhe të atyre strategjike. Për të reduktuar deficitin fiskal duke rritur të ardhurat e buxhetit, që ranë ndjeshëm si rezultat i krizës së thellë, qeveria rriti ndjeshëm VAT-in në 20% duke ushtruar, për momentin, presion për rritjen e çmimeve, i cili gjithësesi nuk u vërtetua shumë. Pjesë e rëndësishme e programit ishte mbyllja, administrimi, transparenca dhe likuidimi i shoqërive piramidale.¹⁹ Një nga faktorët më të rëndësishëm që pakësoi pasojat negative të krizës dhe ndikoi në ristabilizimin e shpejtë ishte ***vendimi kurajoz i marrë nga të gjitha qeveritë për të mos dëmshpërblyer kreditorët nga buxheti i shtetit.***

Banka qendore në mast e marra për mënjanimin e efekteve të krizës në sektorin bankar dhe për stabilizimin e treguesve makroekonomikë pezulloi dhënien e kredive për banka që kishin nivelin e huave të këqija mbi 20% dhe rriti normat minimale të interesit vjetor për depozitat gati në 30%. Këto masa frenuan dhënien e huave risikoze dhe përmirësuan portofolin e bankave dhe bënë që niveli i depozitave të rritet përsëri. Kjo rritje që pasqyronte edhe një rritje të besimit ndaj bankave siguroi mundësinë që bankat të kenë likuiditet të mjaftueshëm, i cili u përdor kryesisht për blerje të bonove të thesarit dhe një pjesë e vogël për të rritur kredinë në sektorin privat.

Një ndër masat e rëndësishme për zgjidhjen e krizës ishte thellimi i reformës strukturore në sistemin bankar. Dobësitë e theksuara të këtij sistemi, të cilat u shfaqën edhe në rritjen e normës së kredive të këqija e cila në banka të veçanta si Banka Tregtare Agrare arriti në 90% u shoqërua me masa që synonin forcimin e tyre. Banka Tregtare Agrare u likuidua, Banka Kombëtare Tregtare u privatizua ndërkohë që Banka e Kursimeve u fut në proces të përgatitjes së privatizimit duke punuar në një marrëveshje administrimi në asistencën e këshilltarëve të huaj. Për të thelluar procesin e ristrukturimit të bankave u revokua licenca Bankës Tregtare Agrare dhe një pjesë e aktiveve të kësaj banke u transferuan në Bankën e Kursimeve, ndërsa aktivet me probleme u transferuan në Bankën Kombëtare Tregtare dhe në Agjencinë e Trajtimit të Kredive (agjenci që u krijua për trajtimin e kredive të këqija të bankave me kapital shtetëror). Masat e marra për forcimin e sistemit bankar konsistonin në përmirësimet ligjore, të cilat synonin forcimin e rolit mbikëqyrës të Bankës Qendrore, parandalimin e lindjes së sektorit informal të kreditimit dhe përmirësimin e sistemit të pagesave dhe të infrastrukturës bankare.

¹⁹ Për një trajtim të hollësishëm shih Chris Jarvis "The Rise and Fall of the Pyramid Schemes in Albania", IMF Staff Papers, Volume 47, Number 1, 2000.

Si përfundim, kriza piramidale ishte një krizë që u ndihmua nga dobësitë e sistemit bankar, por që nuk lindi nga bankat dhe asnjë bankë nuk u përfshi në aktivitetet piramidale apo të mbështeste ato, siç ndodhi me segmente të tjera të qeverisjes. Përkundrazi Banka Qendrore ishte i vetmi zë paralajmërues për rrezikun e tyre.

Dobësitë në qeverisje, paftësia për të menaxhuar situatën e krijuar nga toleranca dhe suporti shtetëror, mungesa e kuadrit ligjor dhe pritjet e gabuara të publikut që kishin një bazë të trashëguar, por edhe mbështeteshin mbi informacionin e gabuar dhe të kufizuar për shoqëritë kapitaliste, të gjitha këto përbëjnë shtratin ku u ushqyen dhe u rritën skemat piramidale që ishin me pasoja të gjithanshme për shoqërinë shqiptare.

4. ZHVILLIMET NË SEKTORIN BANKAR, '97-'02, DHE KRIZA E DEPOZITAVE

4.1. Kuadri makroekonomik.

Gjatë kësaj periudhe u rivendos me shpejtësi stabilizimi makroekonomik dhe reformat strukturore shënuan progres lidhur me thellimin dhe përfundimin e privatizimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe me hartimin e strategjisë së privatizimit të ndërmarrjeve të mëdha dhe të shërbimeve publike. Politikat monetare e fiskale të ndjekura dhe thellimi reformave, çuan në një rritje mesatare vjetore të PPB prej 7.4% dhe në uljen të inflacionit në nivelin 3.5% në vitin 2001. Me gjithë tendencën renëse të deficitit buxhetor dhe të llogarisë korente ato mbetën në nivele negative relativisht të larta, përkatësisht 8.5% dhe 7.4 % të PPB-së në vitin 2001. Politikat stabilizuese të ndjekura pas vitit '98 fillimisht pasuan rritjen e normave të interesit dhe, pas reagimit të shpejtë dhe të drejtë të publikut, shumë shpejt çuan në një ulje të ndjeshme të inflacionit në nivelin 8.7%, në fundin e vitit '98.

Me uljen e theksuar të inflacionit deri në 3.2 %, madje në nivele negative në vitin '99, kemi një zbutje të politikës monetare duke ulur ndjeshëm normat e interesit. Gjatë kësaj periudhe, instrumentet e politikës monetare evolucionuan sepse roli i kufirit të kreditit ra ndjeshëm derisa në vitin '99 u shua si instrument duke përdorur vetëm normën e interesit të depozitave për bankat me kapital shtetëror, të cilat shumë shpejt u zëvendësuan vetëm me instrumentet e tregut, ku instrumenti kryesor është norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes (Kule, Hadëri, 2001).

4.2. Zhvillime dhe problemetë të sistemit bankar, '97-02.

Në këtë periudhë, kanë shënuar progres të rëndësishëm edhe reformat e sektorit financiar që lidhen me privatizimin e bankave shtetërore dhe me hyrjet e bankave të reja private, të cilat kanë ndikuar në thellimin e ndërmjetësimit financiar dhe

në rritjen e cilësisë së shërbimeve bankare. Vitet '97 – 02 karakterizohen nga një vëmendje dhe angazhim më i madh në thellimin e ristrukturimit dhe të reformës në sistemin bankar.

Karakteristikë e parë e këtyre zhvillimeve ishte rritja e numrit të bankave nëpërmjet bankave të reja private, të cilat aktualisht kapin shifrën 14. Në vitin 1997 u licencua një bankë tjetër me kapital tërësisht të huaj, Banka Ndërkombëtare Tregtare, ndërkohë që në vitin 1998 u licencua Banka Amerikane e Shqipërisë dhe Dega e Tiranës e Bankës Alpha Credit. Në vitin 1999 filluan aktivitetin edhe tre banka të tjera, Banka e Parë e Investimeve, Banka Ndërtregtare²⁰ dhe Banka Fefad, ndërsa në vitin 2002 u licencua Banka Shqiptare e Kreditit, bankë e huaj private me kapital kuvajitian. Dominimi i bankave të huaja private, ku aktualisht vetëm Banka e Kursimeve mbetet me kapital shtetëror përbën një veçori tjetër të sistemit bankar shqiptar.²¹ Aktualisht, Shqipëria ka 4.5 banka për një milion banorë ndërkohë që Bullgaria ka thujse të njëjtin tregues, Rumania ka 1.5 banka për një milion banorë, Hungaria 3 banka dhe Kroacia 10 banka.

Karakteristikë tjetër e rëndësishme në këtë periudhë është ulja e dominimit të bankave me kapital shtetëror, si nëpërmjet likuidimit të Bankës Tregtare Agrare dhe privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare, ashtu edhe nëpërmjet hyrjes së bankave të reja private. Tabela e mëposhtme jep qartë këtë prirje lidhur me peshën e aktiveve të grupbankave sipas viteve: Grupi parë ku përfshihen bankat me kapital shtetëror, i cili mbas privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare në vitin '99, përbëhet vetëm nga Banka e Kursimeve, ka ardhur duke rënë gradualisht nga 89.9% të totalit të aktiveve të sistemit bankar në vitin '97 në 59.2 % në vitin 2001. Ndërkohë që grupi 3 ku futen bankat me kapital tërësisht privat ka pësuar rritje të vazhdueshme nga 3.6% në vitin '97 në 35 % në vitin 2001. E njëjta prirje shfaqet edhe në peshën që zënë depozitat sipas grupeve të klasifikura, G 1 ka ardhur në rënie ndërkohë që G3 është rritur.²²

Aktiviteti bankar ka ardhur duke u zgjeruar bashkë me zgjerimin e bankave në treg, duke u rritur si aktivet ashtu edhe depozitat e bankave. Totali i aktiveve të sistemit vitin '98 shënon një rritje prej 39 miliardë lekësh nga viti 1997²³ duke arritur në 206 miliardë lekë ose 44.7% të PBB-së. Në vitin '99 aktivet e sektorit bankar rriten në 250 miliardë lekë ose rreth 49.3% të PBB-së. Kjo rritje vjen si

²⁰ Me ndryshimin e emrit të saj, tashmë kjo bankë emërtohet "Banka Tregtare e Greqisë, Al".

²¹ BK ndodhet në procesin e privatizimit dhe u është ofruar të huajve për blerje.

²² Pesha e G 1 ka rënë nga 93% në vitin '97 në 68 % në shtator 2002. (shih tabela 7).

²³ Të dhënat për vitin 1998 janë në përshtatje me sistemin e ri kontabël, me hyrjen e tij në fuqi në fund të vitit 1998. Kështu, krahasimi me vitin 1997 nuk mund të konsiderohet plotësisht i saktë, por përderisa pasqyrimet në total të zërave të bilancit midis dy sistemeve ndryshojnë lehtë, krahasimi është realizuar. Ndryshim i konsiderueshem midis dy sistemeve ekziston në metodën e klasifikimit të kredive dhe për këtë arsye në momentin e analizimit të cilësisë së portofolit të kredive, periudha e nisjes do të jetë viti 1998.

nga Banka e Kursimeve, ashtu edhe nga hyrja në treg e tri bankave²⁴ të tjera me kapital të huaj. Në vitin 2000, megjithëse nuk shtohet ndonjë bankë e re, banka të veçanta kanë përjetuar ndryshime sinjifikuese. Totali i aktiveve të sistemit, megjithë pakësimet e ndodhura në Bankën Kombëtare Tregtare, evidenton rritje prej 21 miliardë lekësh²⁵ nga viti 1999, duke rezultuar 271 miliardë lekë në fund të vitit 2000, ose 50.2% e PBB-së.). Në fundvitin 2001, totali i aktiveve të sistemit rezulton 318 miliardë lekë ose rreth 54% e PBB-së. Në këtë rritje prej 47 miliardë lekësh nga viti 2000, ka ndikuar kryesisht grupi i bankave G3 me rreth 33 miliardë lekë dhe grupi G1. Nga ana tjetër, niveli i depozitave ka shënuar rritje të vazhdueshme nga 178.2 miliardë lekë në vitin '98 në 282 miliardë në vitin 2001.

Niveli i ndërmjetësimit financiar është thelluar më tej duke pasqyruar prirjen pozitive të zhvillimeve në sektorin bankar. Raporti i depozitave totale ndaj PPB – së, që është një nga treguesit kryesorë të nivelit dhe thellësisë së ndërmjetësimit financiar, ka ardhur duke u rritur gjatë gjithë periudhës së tranzicionit dhe veçanërisht mbas vitit 1998, duke shënuar nivelin 47.9 % në vitin 2001. Të njëjtën prirje shfaq edhe raporti i depozitave me afat ndaj PPB-së, si treguesi më sinjifikativ i ndërmjetësimit, i cili është rritur ndjeshëm nga 12.8% në vitin 1994, në 29.3% në vitin 1998 dhe 38% në vitin 2001. Kjo prirje përforcohet edhe nga një tregues më i gjerë i ndërmjetësimit, raporti para gjithsej ndaj PPB-së i cili ka ardhur duke u rritur dhe aktualisht kap nivelin 66.7% (tabelë 1).

Një karakteristikë tjerë e zhvillimeve pozitive në sektorin bankar është përmirësimi i tregut të kreditit. Dy janë prirjet më pozitive që vihen re në këtë treg: e para rritja e vazhdueshme e kreditimit të sektorit privat dhe e dyta ulja e kredisë me probleme ndaj totalit të kredisë (NPL) e cila në qershor të vitit 2002 arrin nivelin 7.4% dhe po të përjashtosh Bankën e Kursimeve, e cila zë pjesën kryesore në këtë raport, prirja del më e qartë, ky raport ka lëvizur nga 10.8% në vitin 1998 në 6.9% në vitin 2000.

Përmirësimi i vazhdueshëm i mbikëqyrjes bankare si nëpërmjet pëmirësimeve ligjore ashtu edhe hartimit dhe përsosjes së rregulloreve në fushën e licencimit, mbikëqyrjes dhe rregullimit përbën një dukuri tjetër pozitive të kësaj periudhe. Aktualisht, Banka e Shqipërisë përdor një sistem bashkëkohor të vlerësimit të bankave të nivelit të dytë (CAMELS), sistem i cili zbatohet mbi bazën e strukturave përkatëse të burimeve njerëzore dhe të bazës ligjore.

Megjithatë, në zhvillimet e kësaj periudhe shfaqen edhe një sërë mangësishë që përbëjnë sfida për t'u zgjidhur. Së pari, dominimi i tregut bankar ku një bankë e

²⁴ Sikurse është përmendur dhe më parë, në vitin 1999 fillojnë aktivitetin e tyre, Banka Fefad, Banka Tregtare e Greqisë dhe Banka e Parë e Investimeve.

²⁵ Depozitat si sitem bankar, janë rritur 20.4 miliardë lekë nga viti 1999, si dhe kapitali aksioner (si sitem bankar) evidenton rritje prej 9.1 miliardë lekësh, krahasuar po me fundvitin 1999.

vetme zë rreth 55% të sistemit bankar, ndërsa dy bankat kryesore zinin rreth 70% në fund të vitit 2001. Kjo situatë kufizon ndjeshëm konkurrencën në sistemin bankar duke sjellë pasoja si për politikën monetare të Bankës së Shqipërisë dhe të administrimit të borxhit të brendshëm ashtu edhe në zhvillimin e sektorit bankar dhe në rritjen e efektivitetit të tij.²⁶

Konkurrenca e ulët e sistemit shprehet edhe në nivelin e shërbimeve si nga parametrat e atij ekzistues apo siç quhet "klasik" ashtu edhe nga futja e shërbimeve të reja më eficiente si investimet bankare, etj. Shërbimet bankare janë të lidhura në njëfarë mase dhe me përsosjen e sistemit të pagesave, i cili ndodhet në procesin e ndryshimeve të mëdha sidomos me futjen e sistemit RTGS.

Pavarësisht faktit që bankat janë institucionet më të rregulluara në vend dhe përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit mbikëqyrës nga Banka e Shqipërisë që nga viti '97,²⁷ ku nga zhvillimet më të fundit është ngritja e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, sistemi bankar vlerësohet të ketë ecur më shpejt se kuadri rregullator i bankës.²⁸(Treichel, 2001).

Megjithë rritjen e nivelit të kreditimit të ekonomisë ai mbetet në nivele relativisht të ulta dhe mjaft poshtë atyre të vendeve të përparuara. Kështu, raporti i kredisë për sektorin privat ndaj PPB-së megjithëse është rritur, është vetëm 4.6% në vitin 2001. Ndërsa kjo kredi ndaj kredisë gjithsej zë vetëm 14.1% në vitin 2001. Kjo del qartë po të shikojmë strukturën e aktiveve ku bonot e thesarit zënë një peshë të rëndësishme në sistemin bankar me mbi 51.7% të aktiveve të tij. Ndërkohë, vetëm Banka e Kursimeve zë 71% në vitin 2001. Megjithatë, bankat private shfaqin prirjen për të qënë më agresive si në kredinë për ekonominë ashtu edhe në bonot e thesarit.

4.3. Gjendja e sistemit bankar në prag të krizës së depozitave.

Vlerësimi i sistemit bankar në fund të viti 2002 i matur në treguesit e performancës së tij (tabelë 6.) tregon që "shëndeti" i tij ka ardhur duke u përmirësuar në të gjithë këta tregues. Kjo duket qartë po të shikojmë më në detaje cilësinë e aktiveve të sistemit bankar dhe të bankave të veçanta, mjaftueshmërinë e kapitalit, treguesit e likuiditetit dhe fitimet e sistemit bankar.

²⁶ Për një trajtim më të hollësishëm shih Baleta et al., "Dominimi i Tregut Bankar Shqiptar", Banka e Shqipërisë, Material Diskutimi, Nr. 3/(4)/00, 2000.

²⁷ Së fundi më 29 mars 2002 Parlamenti Shqiptar miratoi ligjin "Për sigurimin e depozitave".

²⁸ Sipas Treichel, 2001, diversifikimi i aktiviteteve bankare kërkon fuqizimin e teknikave moderne të administrimit të riskut nga bankat tregtare.

Cilësia e aktiveve të sistemit bankar mund të analizohet duke u përqendruar në rrezikun e investimeve në letra me vlerë²⁹ dhe të rrezikut të kredisë. Investime në letrat me vlerë gjenden në portofolin e vetëm disa bankave, të cilat nuk janë të detyruara të raportojnë në Bankën e Shqipërisë lidhur me *rating*-un e tyre. Ndërkohë, është Banka e Shqipërisë që i ekzaminon në vend bankat e sistemit duke evidentuar cilësinë e aktiveve të tyre, e cila në periudhën e fundvitit 2001 rezulton e lartë sepse ato përfaqësojnë kryesisht letra me vlerë të qeverive të zonës A.³⁰ Cilësia së portofolit të kredive është treguesi më i rëndësishëm e cili matet me një varg treguesish.³¹ Në llogaritjen e këtyre treguesve përveç sistemit në tërësi duhet të llogariten edhe për sistemin pa BK si banka e vetme me kapital shtetëror dhe me disa veçori që vijnë nga fakti së një pjesë e mirë e kredisë me probleme janë llogari të mbartura nga ish Banka e Shtetit Shqiptar dhe Banka Tregtare Agrare dhe së mbas vendosjes së normës prej 20% si kufi për dhënien e kredive, teprica e kredisë për këtë bankë u ul ndjeshëm duke përkeqësuar treguesin statistikisht.³²

Ecuria e këtij treguesi, ku kredia me probleme zinte një nivel të lartë ndaj tepricës së kredisë deri në vitin 2001, kur u bë dhe pastrimi i huave të këqija bashkë me provigjonet për shkak të përgatitjes së Bankës së Kursimeve për privatizim, shpreh një shkallë të lartë rreziku i cili është i mbuluar me një nivel të lartë provigjonimi, e cila ul realisht këtë rrezik. (tabelë 5) Megjithëse krahasuar me standardet, niveli i këtij treguesi mbetet i lartë, 6.9 % në vitin 2001, mungesa e aftësisë paguese për sistemin nuk përbënte shqetësim për shkak të nivelit të ulët të kredive në totalin e aktiveve (tabelë 1)³³.

Pjesë e rrezikut të kreditit ndaj të cilit ekspozohet sistemi bankar është pesha e kredisë në valutë ndaj totalit të kredisë. Kredia në valutë i ekspozon bankat ndaj rrezikut të kreditit, kur kjo lidhet me kredimarrës që disponojnë të ardhura në lekë, sepse një përkeqësim i kursit të këmbimit, domethënë një nënçmim i lekut, do të dobësonte aftësinë paguese të kredimarrësve gjë që do të ndikonte në rritjen e kredive me probleme në portofolet e bankave.³⁴ Kredia në valutë, në

²⁹ Përjashtuar bonot e thesarit.

³⁰ Ndërkohë, nëse ky portofol i letrave me vlerë klasifikohet "i tregtueshëm dhe njëkohësisht plotëson kushtin tjetër, mbi 5% të bilancit, atëherë bankat janë të detyruara të plotësojnë rregulloren e "Risqeve të Tregut", nëpërmjet së cilës del qartë se sa të ekspozuara janë bankat ndaj këtyre rreziqeve.

³¹ Si matës i efektivitetit të menaxhimit të këtij portofoli, është raporti i kredive me probleme ndaj tepricës së kredisë (për bruto). Ndërkohë, si matës i *ekspozimit të sistemit bankar ndaj rrezikut të kreditit*, është raporti i kredive me probleme neto ndaj tepricës së kredisë neto. Analiza e bazuar në treguesin neto (të zhveshur nga provigjonet) evidenton madhësinë neto të rrezikut ndaj të cilit ekspozohet sistemi bankar.

³² Në tepricën e kredisë me probleme të vitit '88 prej 12.9 miliardë lekësh, Banka e Kursimeve zë shumën prej 10.9 miliardë lekësh ose 84.8% e tepricës së kredisë me probleme të sistemit. Kështu, raporti i kredive me probleme ndaj tepricës së kredisë (bruto) rezulton 35.4% për tërë sistemin, ndërkohë që në Bankën e Kursimeve ky tregues llogaritet 59.7%. Po të përjashtojmë Bankën e Kursimeve, treguesi i mësipërm rezulton 10.8 %.

³³ Madje po të shikojmë dy bankat që pësuan tërheqjen e depozitave gjatë panikut, Bankën e Kursimeve dhe Bankën Kombëtare Tregtare, huatë e tyre zinin më pak se 0.5 të aktiveve totale.

³⁴ Për një vlerësim më të saktë të raportit të kredive me probleme korreluar me ecurinë e kursit të këmbimit, është në faza fillestare puna për krijimin e një ekuacioni regresioni, ku raporti i kredive me probleme konsiderohet variabël i varur dhe kursi i këmbimit variabël i pavarur. Flitet për një punë në faza fillestare, sepse nevojitet një seri kohore e tij me më shumë

fundvitin 2001 përbën 81.7% të totalit të tepricës së kredisë, por ndërkohë kredia me probleme në valutë ndaj totalit të kredisë në valutë zë 7.9%.

Në fundvitin 2001, raporti i kredisë me probleme ndaj tepricës së kredisë (neto) është 4% (i cili konsiderohet ende në nivele të ulta). Si përfundim i analizës së cilësisë së aktiveve të sistemit bankar mund të thuhet se bankat, megjithëse janë të kufizuara në investimet e huaja në tregje ndërkombëtare, në tregun vendas janë duke zgjeruar aktivitetin e tyre kredihënës nga një periudhë në tjetrën, duke ruajtur një nivel të kënaqshëm të cilësisë së portofoleve të tyre.

Kapitali aksioner përbën fondet e veta të bankës, nivelet e shëndosha të të cilit sigurojnë besimin tek publiku për stabilitetin e bankave dhe sistemin bankar në tërësi, mbështesin aktivitetin e bankave, sigurojnë mbështetje të qëndrueshme për humbjet e trashëguara dhe të humbjeve të paparashikuara si dhe i japin mundësi bankave në përmbushjen në vazhdimësi të kërkesave për kredi.³⁵ Kapitali bankar ndikon si amortizues për shqetësimet e bankave lidhur me aftësinë paguese duke parandaluar falimentimin e tyre. Le të analizojmë dy treguesit kryesorë të nivelit të kapitalit bankar: levën financiare dhe raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

Leva financiare që tregon strukturën e fondeve të një institucioni jepet si raport i kapitalit aksioner të bankës ndaj totalit të aktiveve. Ky tregues për sistemin bankar rezulton 6.3% në fund të vitit 2001, ndërkohë që në sektorin bankar si nivel standard konsiderohet intervali 5-9%. (BSH)

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit përcakton aftësitë e bankës për të përballuar humbjet e mundshme të saj. Llogaritja e këtij treguesi bazohet në metodologjinë e vendosur sipas Marrëveshjes së Komitetit të Bazelit mbi Mbikëqyrjen Bankare në vitin 1998,³⁶ sipas të cilës në vendin tonë ky raport është vendosur të jetë 12 % nga autoriteti mbikëqyrës.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit, llogaritur në mënyrë agregate për tërë sistemin bankar rezulton 35.3%³⁷ në fund të vitit 2001, i cili është mjaft më i lartë së norma minimale. Ecuria e këtij treguesi për sistemin tregon qartë tendenca në rënie e tij, e cila gjithësesi tejkalon ndjeshëm normën minimale dhe nuk supozon aftësi më të pakta të bankave për të përballuar humbjet e mundshme, por flet

së 30 të dhëna që mungojnë aktualisht sepse klasifikimi i kredisë nga bankat bëhet një herë në tre muaj dhe sistemi i ri kontabël ka hyrë në fuqi në fundvitin 1998.

³⁵ Sipas Cani dhe Vika 2002, zvogëlimi i mjaftueshmërisë së kapitalit përbën një karakteristikë që shoqërojnë krizat financiare në shumë raste të studiuara.

³⁶ Kështu, sipas kësaj kornize të matjes së rrezikut, bankat duhet të përcaktojnë aktivet e tyre në njërin prej 4 kategorive (nga 0% deri në 100% risk) në bazë të riskut të kreditit të huamarrësit dhe kapitali rregullator i bankës nuk duhet të bjerë nën 12% të totalit të këtyre aktiveve të ponderuara me rrezikun.

³⁷ Ndërkohë, në nivel individual çdo banke e sistemit evidenton raport të lartë për këtë tregues. Bankat me vlera më të ulta (kuptohet mbi normë) janë ato me aktivet dhe që flasin për rritje të konkurrencës.

për shtrirje gjithnjë e më shumë të sistemit bankar në aktivitete mëtë rrezikshme të tilla si kredidhënia. Si përfundim mund të thuhet se bankat e sistemit, duke qenë në fazën e rritjes dhe duke ndërmarrë pak aktivitete risikoze nga ana e tyre, karakterizohen nga norma të larta të mjaftueshmërisë të kapitalit, gjë që nuk i shërben aspak lindjes së një krize financiare, madje lenë hapësirë për zhvillime të mëtejshme.

Rentabiliteti i matur me treguesit e tij, ROA dhe ROE, përfaqëson një tregues tjetër të rendësishëm që shërben për të vlerësuar ecurinë historike të bankës dhe mbi këtë bazë, aftësinë e saj për të paguar detyrimet e ardhshme ndaj depozituesve të saj. Pas një periudhe humbjeje deri në vitin '99, vitet e fundit sistemi bankar rezulton me fitim,³⁸ respektivisht 5.4 dhe 4.3 miliardë lekë në vitet '00 dhe '01.

ROA (kthyeshmëria nga aktivet), që është një tregues i eficiencës menaxheriale dhe tregon së sa kompetente kanë qenë bankat në konvertimin e aktiveve të tyre në të ardhura neto, rezulton 1.15 % në bazë vjetore, ndërsa ROE (kthyeshmëria nga kapitali i vet) 18.6 %.

Likuiditeti përbën një tregues tjetër me rëndësi për analizën e shëndetit të sistemit bankar sepse lidhet drejtpërdrejt me aftësinë paguese të bankës dhe me rrezikun për falimentim. Analiza e treguesve të likuiditetit³⁹ në fund të vitit 2001 tregon se në pragun e krizës gjendja e likuiditetit në sistemin bankar ishte relativisht e shëndoshë, e cila shprehet në nivelin e këtyre treguesve, ku aktivet likuide zinin rreth 90% të aktiveve totale dhe më shumë së gjysma e tyre ishin bono thesari, ndërsa raporti i aktiveve likuide ndaj pasiveve totale afatshkurtra ishte mbi 98%. Më i përmirësuar paraqitet ky tregues në bankën ku filloi dhe pati intesitetin më të lartë paniku bankar, Banka e Kursimeve, në të cilën të gjitha aktivet e saj ishin likuide.

Si përfundim, mund të thuhet se pragu i krizës nuk mund të vlerësohej aspak i tillë nga ekonomistët dhe autoritetet mbikëqyrëse po të mbështetemi në praktikat e studiara dhe treguesit që sinjalizojnë për krizën. Treguesit makroekonomikë dhe treguesit e performancës bankare ishin në nivele të tilla që nuk flisnin për një krizë në horizont, përveç.....

4.4. Humbja e besimit të publikut, kriza e depozitave dhe Banka e Shqipërisë.

³⁸ Me përjashtim të Bankës Italo-Shqiptare dhe Bankës Kombëtare të Greqisë të cilat rezultojnë me humbje, në fund të kësaj periudhe, bankat e tjera të sistemit evidentojnë rezultate financiare pozitive.

³⁹ Treguesit e likuiditetit janë të ndryshëm si raporti i aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve, aktive likuide ndaj pasiveve afatshkurtra, teprica e kredisë neto ndaj depozitave mesatare, hendeku i maturimit deri në një muaj.

Sistemi bankar u përball me panikun e depozitave në muajin mars të vitit 2002 që përbën ngjarjen më të rëndë për sektorin financiar shqiptar pas vitit '97 dhe, ajo që është më e rëndësishme një ngjarje të pastër të sektorit bankar. Analiza e shkaqeve që çuan sistemin bankar në një panik bankar dhe në pragun e një krize financiare tregon jo vetëm brishtësinë e sistemit bankar që *buron nga natyra e brendshme e tij si sistem që mbështetet në besimin e publikut, por edhe brishtësinë e sistemit bankar shqiptar të tranzicionit që mbështetet në një besim të brishtë të publikut.*

Historia e shifrave që pasqyron fillimin dhe intesitetin e panikut jepet në tabelën përmbledhëse (tabelë 8), e cila paraqet rrjedhën dalëse të depozitave për sistemin dhe bankat që u prekën nga ajo. Paniku filloi dhe u zgjerua kryesisht në Bankën e Kursimeve e cila ndodhej në prag të privatizimit dhe zinte pjesën më të madhe të sistemit bankar dhe më pak në Bankën Kombëtare Tregtare si banka e dytë e vendit për nga madhësia.⁴⁰

Rrjedhjet e depozitave nga këto dy banka arritën në 12 miliardë lekë, në mars dhe 9.4 miliardë lekë në prill, ndërkohë që Banka e Kursimeve zinte 96.3% të tyre, e cila solli edhe peshën e uljes së kësaj banke në sistemin bankar nga 59.2 % në fund të vitit '01 në 56.6% në prill '02. (BSH)

Përtej historisë së shifrave dhe të ambjentit pozitiv të sistemit bankar paniku u bë fakt dhe si i tillë ai ka shkaqet e veta, të cilat duhen kërkuar në rrethana të tjera të kësaj periudhe dhe në faktorët që formojnë pritjet e publikut dhe besimin e tij ndaj sistemit bankar. Mungesa e informacionit dhe asimetria e tij kanë një ndikim të konsiderueshëm në formimin e pritjeve jo të sakta të publikut. Nuk është rastësi që tërheqja e depozitave filloi dhe u zgjerua së pari në zonat rurale ku njohuritë për sistemin bankar dhe vlerësimin e tij si dhe informacioni për to është shumë i kufizuar.

Publiku shqiptar fitoi një përvojë në vitin 1997, përvojë që i kushtoi atij jo pak, e cila e bëri atë më të ndjeshëm ndaj rrezikut të humbjes së depozitave. Megjithatë pas krizës së vitit 1997 publiku iu drejtua bankave, veçanërisht bankave me kapital shtetëror për të depozituar kursimet e veta (tabelë 6, 7). Kjo dukuri mbështetet në faktin e përmendur më sipër se bankat nuk u përfshinë direkt në skemat piramidale dhe ndikimi i këtyre të fundit mbi to ishte shumë i vogël gjë që ndihmoi rritjen e besimit të publikut ndaj tyre dhe në faktin që depozitat në bankat shtetërore nënkuptonin një sigurim implicit të tyre nga ana e shtetit si pronar.⁴¹

⁴⁰ Kjo bankë, e cila u privatizua në vitin 1999 ka të ngjarë që të konsiderohej akoma si shtetërore nga një pjesë e publikut të paimformuar veçanërisht në zonat rurale, ku filloi edhe paniku dhe pati intesitetin më të madh.

⁴¹ Lëkundja e besimit të trashëguar ndaj shtetit mbas falimentimit të skemave piramidale për shkak të mbështetjes që iu dha shteti atyre, nuk u shtri në bankat shtetërore ndofta për faktin që shteti deklaroi prerë dhe faktikisht e mbajti

Në këtë kontekst gërshetimi i dy ngjarjeve siç ishte ofrimi i Bankës Kursimeve për privatizim dhe miratimi i ligjit të sigurimit të depozitave në këtë kohë, të mpleksura dhe me faktorë politikë tronditën besimin e publikut ndaj bankave duke çuar në tërheqje masive depozitash. Privatizimi i Bankës Kursimeve, në një kohë kur qeverisja karakterizohej nga probleme serioze dhe mungesë e stabilitetit dhe, nga ana tjetër, argumenti i opozitës se privatizimi dhe dhënia e bankave të huajve do të cënonte sigurinë e depozitave, si një mjet i luftës politike, e shoqëruar dhe me rënien e besimit të sigurimit implicit për shkak të diskutimeve për madhësinë e nivelit të depozitave që do të siguroheshin me ligj, nxiti formimin e pritjeve jo të sakta për këto banka duke çuar në panik.

Si përfundim, për shkak të trashëgimisë nga sistemi socialist, të zhvillimeve negative të periudhës së tranzicionit, të edukimit të pamjaftueshëm të publikut për sistemin bankar, të informacionit asimetrik dhe të mungesës së tij, të zhvillimeve luhatëse politike, të brishtësisë të zhvillimit të tërë ekonomisë shqiptare përfshirë edhe ekonominë reale, pritjet e publikut dhe mbi këtë bazë niveli i besimit mbi sistemin bankar mbeten të brishta. Në këto kushte, përkundrejt zhvillimeve pozitive dhe treguesve pozitiv në rritje të performancës së sistemit bankar, ai është i ekspozuar ndaj rreziqeve dhe krizave të mundshme dhe si i tillë edhe ai mbetet i brishtë.

Nga ana tjetër, kriza e depozitave pati pasoja edhe mbi ekonominë reale, sepse ulja e depozitave u shoqëruar me rritjen e parasë jashtë bankave duke rritur presionet inflacioniste dhe me krijimin e problemeve të likuiditetit për bankat e nivelit të dytë. Në këto kushte, Banka e Shqipërisë me përgjegjësinë e autoritetit monetar dhe mbikëqyrës, nëpërmjet instrumenteve në dispozicion ndërhyri duke ndikuar në shuarjen e krizës dhe mënjanimin e pasojave të saj. Ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë e shoqëruar dhe me veprimin e faktorëve të tjerë, veçanërisht atyre ndërkombëtarë, rezultoi mjaft efektive sepse aktualisht paniku konsiderohet i kapërcyer dhe niveli depozitave në fund të muajit shtator ishte 4.8 miliardë lekë më shumë se niveli i parashikuar në programin monetar. (BSH) BSH në rolin e hartuesit dhe të zbatuesit të politikës monetare dhe të mbikëqyrës e regullatorit të sistemit bankar, mori vendimin e rëndësishëm të heqjes dorë përkohësisht nga objektivi kryesor duke u përqendruar në ruajtjen e nivelit të likuiditetit në sistemin bankar, në funksionin e saj si huadhënës i mjetit të fundit. Për këtë qëllim u hoq dorë nga repot dhe depozitat njëditore që shërbenin për tërheqjen e likuiditetit nga sistemi bankar duke përdorur gjerësisht instrumentin e reverse repo dhe lehtësira të tjera si kredia lombard dhe kreditë njëditore nëpërmjet të cilave injektohej likuiditet në treg. Për të mbuluar nevojat e qeverisë

qëndrimin që të mos kompensonte depozituesit për humbjet nga skemat piramidale duke i konsideruar investimin në to si çështje të individëve me firmat private.

për likuiditete u përdor, për një kohë të shkurtër, kredia direkte duke mos prekur kufijtë e përcaktuar nga ligji.

Një masë tjetër në funksion të nxitjes së publikut për të frenuar tërheqjen e likuiditeteve ishte rritja e normave të interesit të repove deri në 1.5%, rritje që nxiste bankat të rrisnin normat e interesit të depozitave dhe normat e tjera të interesit. Ndërkohë Banka e Shqipërisë qëndroi e gatshme për të ndërhyrë në tregun valutor që të ndikonte në stabilitetin e kursit valutor, i cili ishte nën presionin e nënçmimit nga rritja e kërkesës për valutë.

Banka e Shqipërisë vendosi një bashkëpunim të përditshëm me bankat për ndjekjen e situatës si dhe ndërmoi një fushatë edukuese në bashkëpunim me botën akademike, personalitete të njohura të fushës, OJQ-të, politikanë, etj., të cilat patën ndikimin e vet në frenimin e panikut. Një ndikim të konsiderueshëm në këtë drejtim pati edhe mbështetja e faktorit ndërkombëtar.

Si rezultat i kësaj ndërhyrje të Bankës së Shqipërisë dhe i veprimit të faktorëve të tjerë paniku u kapërcye. Niveli i depozitave u rivendos, inflacioni megjithëse u rrit në krahasim me objektivin e një viti më parë, po shfaq shenja uljeje dhe shpresohet të arrihet objektivi në fund të vitit. Kursi pati luhatje të lehta duke pasqyruar edhe besimin e tregut tek Banka e Shqipërisë.

5. KONKLUZIONE.

Sistemi financiar gjatë dekadës së tranzicionit megjithë progresin e dukshëm mbeti në një gjendje të brishtë. Pyetjes së shtruar në titull, progres apo brishtësi do t'i përgjigjeshim: progres i brishtë. Ky progres i brishtë e ka bazën jo vetëm në zhvillimet e brendshme të sistemit bankar, nga trashëgimia e keqe, ngadalësia e reformave, kriza piramidale, vënia e theksit në zhvillimet makroekonomike, por edhe në vetë brishtësinë e konomisë shqiptare në nivel mikro e makroekonomik.

Brishtësia e zhvillimit të sistemit bankar shfaqet në dy momentet më të vështira për të si kriza financiare e shkaktuar nga kolapsi i skemave piramidale dhe kriza e depozitave. Kriza piramidale ishte një krizë që u ndihmua nga dobësitë e sistemit bankar, por që nuk lindi nga bankat dhe asnjë bankë nuk u përfshi në aktivitetet piramidale apo të mbështeste ato, siç ndodhi me segmente të tjera të qeverisjes. Përkundrazi, Banka e Shqipërisë ishte i vetmi zë paralajmërues për rrezikun e tyre. Dobësitë në qeverisje, paftësia për të menaxhuar situatën e krijuar nga toleranca dhe suporti shtetëror, mungesa e kuadrit ligjor dhe pritjet e gabuara të publikut që kishin një bazë të trashëguar dhe informacionin e gabuar dhe të kufizuar për shoqëritë kapitaliste, përbëjnë shtratin ku u ushqyen dhe u rritën skemat piramidale që ishin me pasoja të gjithanshme për shoqërinë shqiptare.

Ndërkohë paniku i depozitave kishte në bazë pritjet e formuara nga kriza piramidale, por lindi në një situatë më të shënoshë dhe të zhvilluar të sistemit bankar duke pasqyruar sa faktin e njohur që sistemi bankar është tepër i ndjeshëm ndaj besimit të publikut, ashtu edhe faktorët që vepruan në atë periudhë si ofrimi i Bankës Kursimeve për privatizim, miratimi i ligjit të sigurimit të depozitave dhe faktorët politikë të cilët tronditën besimin e publikut ndaj bankave duke çuar në tërheqje masive depozitash.

Si përfundim, për shkak të trashëgimisë nga sistemi socialist, të zhvillimeve negative të periudhës së tranzicionit, të edukimit të pamjaftueshëm të publikut për sistemin bankar, të informacionit asimetrik dhe të mungesës së tij, të zhvillimeve luhatëse politike, të brishtësisë të zhvillimit të tërë ekonomisë shqiptare përfshirë edhe ekonominë reale, pritjet e publikut dhe mbi këtë bazë niveli i besimit mbi sistemin bankar mbeten të brishta.

Mësimet që dalin nga kjo analizë janë se zhvillimi ekonomisë reale, thellimi i reformës në sistemin bankar qëndrojnë në themel të krijimit të një sistemi financiar të shëndoshë, konkurrues dhe të aftë që t'i përgjigjet nevojave të ekonomisë në tërësi dhe zhvillimit të sektorit privat në veçanti. Në këtë kuadër, ristrukturimi dhe fuqizimi i tregut financiar dhe nxitja e përmirësimit të shërbimeve bankare përbëjnë dy drejtime bazë të fuqizimit të sistemit bankar, të cilat kërkojnë përfundimin sa më të shpejtë të privatizimit të Bankës së Kursimeve si banka më e madhe në vend dhe me një pozitë dominuese në tregun bankar, forcimin e sistemit të mbikëqyrjes dhe rregullimit të sistemit bankar në përputhje me standardet ndërkombëtare, promovimin e konkurrencës midis bankave, përmirësimin e sistemit të pagesave nëpërmjet instalimit të sistemit Real Time Gross Settlement (RTGS), krijimin e Zyrës së Informacionit të Kredisë dhe promovimin e zgjerimit të skemave të kursim-kreditit dhe rrjetit të sistemit bankar në territorin e vendit.

BIBLIOGRAFIA

- ACER**, "Probleme të rritjes ekonomike në Shqipëri", Përmbledhje e referateve të mbajtura në Konferencën Kombëtare të organizuar nga ACER, 12-13 Mars, 1999.
- "Albania and the World Bank. Building the Future"**, 1994, Washington D.C.
- "Albania"**, 1994, IMF Economic Reviews, 5, July. IMF, Washington D.C.
- Blejer Mario**, et al, 1992, *"Albania: From Isolation toward Reform"*, IMF Occasional Paper 98, Washington D.C.
- Bruno, Michael**, 1992, "Stabilization and Reform in Eastern Europe: A Partial Evaluation" IMF Staff Papers, 39,4, pp. 741-777
- Bezner Drik J.** "Post-Socialist Financial Fragility: the Case of Albania", 2001
- Cani Sh**, *"Restructuring of the banks in Albania"* në Restructuring Eastern Europe, The microeconomics of the Transition Process edited by Soumitra Sharma, Edward Elgar 1995
- European Bank for Reconstruction and Development**, *Transition Report 1996 – 2000* (London, EBRD, 1996 -2000)
- Elbirt, C.** 1997 *"Albania Under the Shadows of the Pyramid Schemes"*, Transition, October 1997. Washington: World Bank.
- GPRS**, Programi Afatmesëm i Qeverisë Shqiptare "Për Rritjen Ekonomike dhe Reduktimin e Varfërisë", Nëntor 2001.
- Hadëri Sulo et al**, "Inflation and Stabilizations in Albania", Post-Communist economies, Vol. 11, No. 1, 1999.
- Hadëri S. Ibrahim F.**, *'Issues on monetary policy during transition in Albania,'* Economic Review of Economics Faculty, 1996
- Ibrahimi F. and Salko D.**, *'Financial System in Albania,'* Albania Between Domestic Reforms and European Itegration, National Conference, BoA, 2001.
- Kule Dh. and Hadëri S.**, *'Macroeconomic Consolidation: Achivement and Challenges,'* Albania Between Domistic Reforms and European Itegration, National Conference, BoA, 2001.
- Ruli G., Stringa O., Hadëri S.**, *"Effectiveness of Monetary Policy and Restructuring of Banking System in Albania,"* Ekonomia dhe tranzicioni, No. 4, 1997.

- Jarvis, Chris**, 1999, "the Rise and fall of the Pyramidic Schemes in Albania", IMF Working Paper 99/98.
- McNeilly, Carryl J. and Schiesser – Gachnangh, Doris**, 1998, "Reducing Inflation: Lessons from Albania's early Success", IMF Working Paper 98/78.
- **Muço Marta**, and **Salko Drini**, 1996, " *Some Issues on the Development of Informal Financial Sector in Albania*", paper presented at the Seminar " Hidden Barriers to Economic Growth in Balkan Peninsula" organized by the Balkan Network, 14 April 1996, at Annual Meeting of EBRD, Sofia, Bulgaria.
- Pashko Gramoz**, 1993, "Inflation in Albania". *Communist Economies & Economic Transformation.*, vol.5, 1, pp.115-126.
- -----, 1996, "Problems of Transition in Albania, 1992-1994", in: I. Jeffries (ed.) *Problems of Economic and Political Transformation in the Balkans*, London: Pinter, pp. 63-82.
- Rother, Philip C.**, 2000, "Inflation in Albania", IMF Working Paper 00/207
- Sadiraj Klarita**, "Albania: Transition to a Market Economy" University of Amsterdam, 1999
- World Bank**, "Albania and the World Bank. Building the Future", 1994, Washington D.C.
- World Bank**, *Albania Beyond the Crisis*, Washington, D.C, 1998
- World Bank**, "Albania Public expenditure and Institutional Review", 2001 Washington.
- Enoch Charles, at.al.** "Banking crises and bank resolution: experiences in some transition economies" IMF Working Paper 02/56, 2002.

SHTOJCË: TABELAT

Tabela1 Tregues te zgjedhur ekonomike

	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	shtator'02
PBB nominale (mio leke)	50.697	125.334	184.393	229.793	280.998	341.716	460.631	506.205	539.210	590.237	639.489
PBB reale	11.235	12.309	13.331	15.106	16.478	15.324	16.547	17.748	19.126	20.367	21283
PBB per fryme ne USD	211	381.5	610.8	737.8	808.9	684.0	906.5	1.080.9	1.094.4	1.332.6	
Rritja e PBB nominale (ne %)		147.2	47.1	24.6	22.3	21.6	34.8	9.9	6.5	9.5	8.3
Rritja e PBB reale (ne %)	-7.2	9.6	8.3	13.3	9.1	-7	8	7.3	7.8	6.5	4.50
Ndryshimi vjetor i ICK-se, ne % (inflacioni)	236.6	30.9	15.8	6	17.4	42.1	8.7	-1	4.2	3.5	
Oferta e parase (M3) (mio leke)	28.771	50.355	70.774.9	107.449.1	154.552.5	198.547.0	239.526.0	292.871.0	328.101.0	393.552.0	406.415
Rritja e ofertes se parase (ne %)		109.7	40.6	51.8	43.8	28.5	20.6	22.3	12	19.9	3.27
Oferta e parase / PBB	56.8	40.2	38.4	46.8	55.0	58.1	52.0	57.9	60.8	66.7	63.6
Paraja jashte bankave (mio leke)	9897.0	17990.0	27627.0	41906.0	47814.0	72726.0	68323.0	81336.0	99236.0	119085.0	129.767
Paraja jashte bankave / M3	34.4	35.7	39.0	39.0	30.9	36.6	28.5	27.8	30.2	30.3	31.9
Te ardhurat e emigrantëve (mio USD)		325.8	377.9	384.6	499.6	266.9	452.3	368.1	530.8	614.9	448
Kredia per ekonomine (mio leke)			9686.0	11440.0	14304.0	15835.0	16315.0	18513.0	23241.0	27938.0	35586
Kredia per ekonomine / Kredise gjithsej (ne%)			10.0	9.5	9.1	12.6	12.0	11.5	13.3	14.1	16.7
Kredia per ekonomine / PBB			5.3	5.0	5.1	4.6	3.5	3.7	4.3	4.7	5.6
Kredia dhene sektorit privat (ne mio leke)			7201	8347	10890	12995	14.862	16.842	22.190	27.391	35.524
Kredia dhene sektorit privat/ PBB			3.9	3.6	3.9	3.8	3.2	3.3	4.1	4.6	5.6
Depozita totale (ne mio leke)			44.455.70	65440.9	103935.2	122891.5	178269.5	214363.2	233086.6	282943.45	279.626
Depozita totale / PBB			24.1	28.5	37.0	36.0	38.7	42.3	43.2	47.9	43.7
Depozita me afat / PBB			12.8	15.8	15.2	25.8	29.3	31.9	33.1	38.0	34.4
Baza monetare (mio leke)	15.043	30.374	42.069	53.876.90	61.392.80	90.927	89.887	109.307	128.779	152.144	
Multiplikatori (M3 / bazen monetare)	1.9	1.7	1.7	2.0	2.5	2.2	2.7	2.7	2.5	2.6	
Norm interes te tregut te parase(BTH 6M)			12.1	14.9	22.3	34.5	21.5	15.5	11.3	9.8	
Kursi i kembimit (mesat periu dhe lek/USD)	75.03	102.06	94.68	92.79	104.5	148.93	150.64	137.69	143.71	143.48	139.3
Rezervat nderkombtarin (ne mio USD)*	37.1	152	208.6	265.3	322.6	341.7	417.8	520.8	642.5	763.5	
Mjete valutore neto / bazen monetare (ne %)			-87.1	24.4	32.9	34.5	40	42.9	55.8	56.5	60.1

*Mjete valutore gjithsej (jo neto)

Burimi: BSH

Table 2 Albania-Main Transition Indicators 1991-2000

	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999
EBRD Index of price liberalization	1.0	2.0	3.0	3.0	3.0	3.0	3.0	3.0	3.0
EBRD Index of forex and trade liberalization	1.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0
EBRD Index of small-scale privatization	2.0	2.0	3.0	3.0	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0
EBRD Index of large-scale privatization	1.0	1.0	1.0	1.0	2.0	2.0	2.0	2.0	2.0
EBRD Index of large enterprise reform	1.0	1.0	1.0	2.0	2.0	2.0	2.0	2.0	2.0
EBRD Index of competition policy	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.7	1.7	1.7	1.7
EBRD Index of banking sector reform	1.0	1.0	.3	2.0	2.0	2.0	2.0	2.0	2.0
General government expenditure	66	46.7	40.4	36.4	33.4	30.3	29.4	30.7	32.6
General government balance	-31	-23.1	-15.5	-12.6	-10.1	-12.1	-12.6	-10.4	-11.3
Privatization revenues	Na	1.1	1.8	3.0	3.1	3.3	3.6	3.6	3.9
Private sector share in GDP	5.0	10.0	40.0	50.0	60.0	75.0	75.0	75.0	75.0

Source: EBRD Transition Report, 2000

Tabelë 3. Pjesa e bankave sipas klasifikimit në tregun bankar, '94-'02.

Pesha në % ndaj sistemit bankar sipas viteve	G1	G2	G3
1994	97.8	1.9	0.3
1995	95.1	4.2	0.8
1996	93.7	4.7	1.5
1997	89.9	6.5	3.6
1998	85.6	5.1	9.3
1999	81.4	5.8	12.8
2000	64.8 ⁴²	6.2	29
2001	59.2	5.8	35
Prill 2002	56.6	5.9	37.5

Burimi: Banka e Shqipërisë

Tabelë 4. Struktura e aktiveve të sistemit bankar.

Struktura e aktiveve	Totali	Totali
Treguesi (ne përqindje ndaj totalit të aktiveve)	Dhjetor' 00	Dhjetor '01
1. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	88.4	85.7
2. Veprimet me klientët (neto)	6.1	8.6
3. Veprimet me letrat me vlerë (neto)	2.9	3.3
4. Mjete të tjera	0.6	0.4
5. Mjete të qendrueshmeE	1.9	1.8
6. Interesa të përlogaritura (neto)	0.1	0.3
Totali i aktiveve	100.0	100.0

Burimi: Banka e Shqipërisë

Tabelë 5. Tregues të performancës së sistemit bankar.

	Dec. '98	Dec. '99	Dec. '00	Dec. '01	Jun '02
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (% , sistemi)	0.0	8.2	42.0	35.6	32.2
Aktivet e ponderuara me riskun(Mil lekë, sistemi)	24.9	48.6	39.6	46.4	51.8
Norma e rritjes së aktiveve (% , sistemi)	-	21.1	8.6	17.6	-1.2
Norma e rritjes së tepricës së kredisë (% , sistemi)	-	17.7	55.6	0.22	17.9
Norma e rritje së depozitave të sistemit (% , sistemi)	-	19.5	10.6	19.2	-4.6
Norma e NPL (% , sistemi)	35.5	32.1	43.1	6.93	7.4

⁴² Banka e Kursimeve evidenton rënie, nga pesha e saj në sistem prej 67.9% në fundvitin 1999.

Norm. rez. për humb. nga huatë ndaj NPL(% sistemi)	96.3	109.5	95.0	44.1	53.8
Norma e kthimit mbas taksave të aktiveve (% sistemi)	-1.8	0.5	2.1	1.5	0.9
Norma e NPL e sistemit pa BK (% sistemi)	10.8	9.7	9.4	6.9	7.3
Norma rez. për humbjet nga huatë ndaj NPL(% pa BK)	82.2	133.7	52.7	42.2	52.3
Norma e kthimit mbas taksave të aktiveve(% pa BK)	-12.8	1.4	3.3	8.7	6.1

Tabela 6 Ecuria e depozitave te sistemit bankar

Teprica e depozitave (ne milione leke)	1997	1998	1999	2000	2001	SHTATOR'02
BK	83,404.00	141,395.60	159,996.40	161,506.20	176,980.00	162,301.06
BTA	4,232.20					
BKT	25,820.00	22,032.70	22,450.50	22,555.30	28,500.04	28,056.61
BISHI	4,987.30	5,635.00	8,845.75	9,894.72	12,484.90	12,813.39
BASHI	492.10	340.90	673.24	635.32	802.14	1,198.34
BD	447.50	880.60	1,029.70	1,467.03	218.40	153.30
BT	1,561.60	2,726.10	5,768.02	9,580.16	15,013.32	19,730.53
BKG	1,894.40	3,275.10	4,420.06	5,733.22	6,870.00	7,382.78
BNT	52.30	331.00	646.17	934.91	1,007.56	1,112.12
BA		1,081.00	3,054.92	5,637.68	9,287.31	12,143.51
ABA		572.10	5,581.07	10,670.60	17,938.10	23,716.98
FEFAD			1,821.56	3,590.51	6,802.04	8,398.21
BPI			35.32	91.47	169.61	790.68
BTG			40.45	789.56	1,744.48	1,828.22
SISTEMI	122,891.50	178,269.50	214,363.24	233,086.62	277,817.90	279,625.71

Burimi: BSH

Tabela 7 Pjesa e bankave sipas klasifikimit në tregun bankar per depozitat, '97-02

Pesha e depozitave te G1 ndaj totalit te sistemit	92.32	91.67	85.11	78.97	73.96	68.08
Pesha e depozitave te G2 ndaj totalit te sistemit	4.46	3.35	4.44	4.52	4.78	5.01
Pesha e depozitave te G3 ndaj totalit te sistemit	3.22	4.97	10.45	16.52	21.26	26.91
	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00

Burimi: BSH

Tabela 8 Ecuria e depozitave gjate panikut

Teprica e depozitave (milione leke)	Dhjetor 2001	Janar 2002	Shkurt 2002	Mars 2002	Prill 2002	Maj 2002	Qershor 2002	Korrik 2002	Gusht 2002	Shtator 2002
Banka e Kursimeve	176,980	180,590	180,407	167,425	157,925	156,700	157,525	158,097	159,886	162,301.1
Banka Alfa	9,287.31	9,558.95	9,744.32	9,648.56	9,586.27	10,098	10,188	10,275	11,760	12,144
Banka Amerikane e Shqiperise	17,938.1	19,369.5	19,418.4	20,089.4	21,005.0	21,671.1	21,878.9	22,285.3	23,411.2	23,717.0
Banka Arabo-Shqiptare Islamike	802.1	855.5	843.8	866.9	844.7	951.0	1,079.32	1,402.05	1,210.33	1,198.34
Banka Dardania	218.4	169.9	183.5	269.9	187.6	185.8	321.4	154.5	334.3	153.3
Banka FEFAD	6,802.0	7,018.2	7,204.9	7,284.9	7,587.6	7,531.6	7,580.5	7,614.4	7,930.0	8,398.2
Banka e Pare e Investimeve	169.6	952.2	938.7	658.7	211.8	209.0	222.9	210.2	652.8	790.7
Banka Italo-Shqiptare	12,484.9	12,597.2	12,437.7	12,449.5	12,180.9	12,810.6	12,439.3	12,510.0	12,831.5	12,813.4
Banka Kombetare e Greqise	6,870.0	6,946.7	6,943.9	6,934.0	6,915.0	6,982.6	6,976.0	6,965.8	7,077.9	7,382.8
Banka Kombetare Tregtare	28,500.0	28,139.0	28,517.0	26,124.5	25,985.1	25,856.3	26,077.5	26,561.4	27,320.7	28,056.6
Banka Nderkombetare Tregtare	1,007.6	1,045.2	951.9	1,055.3	1,031.0	995.5	989.1	1,057.0	1,089.1	1,112.1
Banka Tregtare e Greqise	1,744.5	1,584.7	1,818.9	1,741.9	1,705.9	1,658.1	1,836.9	1,749.6	1,731.1	1,828.2
Banka Tirana	15,013.3	15,735.5	16,134.1	16,152.1	16,707.8	17,661.4	17,966.9	19,426.8	20,125.0	19,730.5
Sistemi bankar	277,817.93	284,562	285,545	270,700	261,873	263,311	265,082	268,309	275,361	279,626
Sistemi bankar pa BK dhe BKT	72,337.86	75,833.462	76,620.0982	77,151.1549	77,963.4699	80,754.5152	81,479.68367	83,650.721	88,153.692	89,268.0377

Teprica e depozitave (milione leke)	Dhjetor 2001	Janar 2002	Shkurt 2002	Mars 2002	Prill 2002	Maj 2002	Qershor 2002	Korrik 2002	Gusht 2002	Shtator 2002
Banka e Kursimeve	176,980.0	180,589.6	180,407.5	167,424.6	157,924.5	156,700.1	157,524.8	158,097.1	159,886.1	162,301.1
Banka Kombetare Tregtare	28,500.0	28,139.0	28,517.0	26,124.5	25,985.1	25,856.3	26,077.5	26,561.4	27,320.7	28,056.6
Sistemi bankar	277,817.9	284,562.0	285,544.6	270,700.3	261,873.1	263,310.9	265,082.0	268,309.2	275,360.5	279,625.7
Sistemi bankar pa BK dhe BKT	72,337.9	75,833.5	76,620.1	77,151.2	77,963.5	80,754.5	81,479.7	83,650.7	88,153.7	89,268.0

Burimi: BSH